



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 27 shtator 2021, në mbledhjen e XLIV (pesëdhjetë e katër) - të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, media televizive dhe të shkruara.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë, theksoi, sigurisht jeni në dijeni për pikat e rendit të ditës për këtë mbledhje, po ashtu edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së i keni marrë me kohë, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kemi diskutuar për rendin e ditës edhe në KPF, pasi jemi në fund të mandatit si Kuvend e që kjo është seanca e fundit e këtij legjislacioni sipas gjitha gjasave dhe duke qenë në dijeni që Kryetari i Komunës mbrëmë gjatë gjithë natës është sjellë nëpër qytet duke i targetuar subjektet opozitare se unë dëshiroj të veproj kështu e ashtu, mirëpo ata (opozita) nuk po dëshirojnë, unë propozoj që në këtë momentum politik që jemi dhe zgjedhjet janë afër ku pas datës 17 tetor do të filloj mandati i ri, e që nuk është e rëndësishme se kush do ta vazhdoj mandatin apo kush do të vije sepse atë besim e japin qytetarët dhe institucioni është në shërbim të tyre, të paktën flas për veti sepse nuk më brengos fakti se kush vjen në krye të Ekzekutivit për arsye se ne jemi në shërbim të qytetarëve këtu, pra propozoj që dy pika të rendit të ditës të mos diskutohen në këtë seancë, dhe atë, 1-propozim vendimi për faljen e borxheve subjekteve afariste, pikë për të cilën kam qenë kundër edhe në mbledhjen e KPF-së ngase bëhet fjalë për disa biznese që sillen si “kapadai”, ose do e mbështetja këtë propozim në qoftë se ndokush nga Ekzekutivi del publikisht dhe merr vendim për rikthim të mjeteve të atyre bizneseve që i kanë paguar obligimet e tyre, pra nëse Ekzekutivi i'u kthen mjetet bizneseve serioze të cilat kanë paguar taksën për këtë buxhet që sot do të shqyrtohet dhe do të kërkohet të miratohet e që sipas drejtorit të DBF ka rritje të buxhetit për vitin 2022 por që kjo rritje nuk ka ndodh prej atyre bizneseve të pa përgjegjshme, ky buxhet është rritur diqysh dhe një ndër faktorët janë edhe pagesat nga shërbimet dhe pagesat e atyre bizneseve që kanë paguar. Prandaj ose të deklarohet drejtori i DBF-së se këtyre bizneseve ua falim borxhet kurse ju bizneset tjera shkoni paguani borxhet, kështu që propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës në

këtë mandat, pastaj në mandatin tjetër të shqyrtohet dhe të falen borxhet sepse edhe unë jam për faljen e borxheve por nuk jam për marrjen e mjeteve këtyre bizneseve tjera, ose të jap një arsyeshmëri përse një numri të bizneseve u janë marrë mjetet, ndërsa një numri të bizneseve tjera nuk po dëshiron t'iu merren mjetet por po propozohet t'iu falen.

2-Sa i përket Hartës Zonale, kjo çështje në këtë Kuvend ka ardh 4 herë, e di që është kërkesë e qytetarëve dhe është ngecje e zhvillimit të ndërtimit, infrastrukturës dhe të specifikimit të çdo elementi të ndërtimit. Në këtë kuvend shqyrtimi dhe miratimi i Hartës Zonale është shtyrë për shkak të LVV-së me arsyetimin se është draftuar ashtu siç ka dëshiruar LDK-ja, pastaj vetë LDK-ja ka qenë ajo që ka deklaruar se miratimi i Hartës Zonale është mirë të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, pra kështu ka qenë realiteti dhe nëse dikush ka kontest atëherë le t'i nxjerrë procesverbalet e diskutimeve. Tani çfarë ka ndodh, është dashur të filloj procesi prej zeros, ka ardh Harta Zonale 3 herë në Kuvend që nga ardhja e Kryetarit Bulliqit në pushtet, madje jo përputhshmëri me ligjin dhe për këtë është kthyer nga Ministria me arsyetimin se Harta Zonale duhet të harmonizohet në bazë të ligjit. Po të ishte Ministri i një subjekti tjetër politik do të kishte mundësi të ishim skeptik që është bërë për këtë ose për atë arsye, por niveli qendror udhëhiqet nga LVV dhe prej të njëjtit digaster ka ardh shkresa që kjo Hartë nuk është në përputhshmëri ligjore dhe duhet të respektohet rruga/baza ligjore, tri herë radhazi, ndërsa sot sërish është sjellë propozimi që të del në dëgjim/shqyrtim publik ajo Hartë, por jo ashtu siç e ka menduar LDK-ja, por ashtu qysh e ka menduar LVV-ja.

Mbrëmë në të gjitha lagjet deri në kufizimin e orës policore zotëri Bulliqi, madje ka shkuar edhe tek Lagjja e Brecalive dhe në të gjitha rrugët duke u shëtitur dhe duke zënë në gojë PDK-në dhe LDK-në. Asnjë përgjegjësi nuk e ka PDK-ja për këtë rrugëtim, për këtë ngecje ligjore, për këtë shtyrje të Hartës Zonale, kështu që kur Podujeva ka qëndruar për 21 vite pa miratim të Hartës Zonale, le të rrinë edhe 1 apo 2 muaj, pastaj Kryetari i ri i Komunës apo Kryetari aktual që është nëse e merr besimin e qytetarëve, apo kush do qoftë ai dhe nga cili do subjekt, apo Kuvendi tjetër i Komunës me përbërje të re çfarë do qoftë ajo, le t'i kryen detyrat e tij si institucion.

Nëse ka menduar Kryetari i Komunës që ta kaloj Hartën Zonale, atë nuk mund ta kaloj me politikën e rrugëve, por mund ta kaloj me përfaqësuesit e popullit që janë ulur këtu në Kuvend të Komunës, këtë e them sepse secilit që është i ulur këtu dikush ia ka besuar votën, prandaj nuk është mirë të bëhen malverzime dhe kontrabandë e votës për interesa personale brenda institucionit kur dihet se vota është dhënë nga qytetarët dhe anëtarët e Kuvendit janë këtu me votën e tyre, përndryshe nuk do të kishte nominime, kandidat nga subjektet politike dhe proces të votave. Kryetari i Komunës është dashur të merret vesh me Kuvendin si Institucion dhe me dhënë arsyeshmërinë e plotë për ta marrë votën këtu, mirëpo Kryetari nuk e ka ndjek këtë rrugë dhe nuk ka ardh në seancë fare madje e që konsideroj se është dashur të jetë prezent në këtë seancë të fundit të kësaj legjislatore, madje LVV-ja dhe të gjitha subjektet tjera kanë gjykuar që Agim Veliu nuk ka marrë pjesë në seanca dhe e ka injoruar Kuvendin, prandaj janë vendimet më të rëndësishme për shqyrtim në këtë seancë të fundit pothuajse të këtij mandati që jemi siç është projektbuxheti i Komunës për vitin 2022 nga i cili dikush pret investime, pastaj Harta Zonale që është dokumenti më i rëndësishëm i Komunës, si dhe shëtitja rrugëve e z.Shpejtim Bulliqit i cili targeton opozitën për pengesa kurse nënshkrimi është i tij, edhe pse këto dy pika me shumicë të votave mund të kalojnë, mirëpo unë propozoj që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës për arsye të cilat mund t'i debatojmë dhe ballafaqohemi me argumente, dhe për këtë nuk po diskutoj si opozitë por si asamblist.

z.Florent Hasani, theksoi, mendoj se rendi i ditës duhet të vazhdojë ashtu siç ka ardh nga KPF-ja me rekomandime të konstatuara. Sa i përket propozim vendimit për shqyrtim publik të Hartës Zonale bashkërisht me të gjithë shefat e Grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike jemi takuar në Zyrën e Kryetarit dhe në atë formë e kemi dërguar në Ministrinë përkatëse, pra ka qenë vendim i

përbashkët edhe pse Ministria ka kthyer përgjigje se ka shkelje procedurale në disa pika, sërish ka qenë vendim i përbashkët dhe mendoj se duhet të vazhdohet me këtë rend të ditës ashtu siç ka ardh nga KPF-ja.

z.Hasan Ajeti, theksoi, arsyeja që më bëri të dal në foltore pikërisht ka të bëjë me Hartën Zonale, është shumë e vërtetë që ne jemi dakorduar, mirëpo është punë e Ekzekutivit që ta sjellë dokumentacionin valid nga Ministria përkatëse, pra nuk është punë e opozitës kjo por është punë e Ekzekutivit. Besoj se drejtori i DPUMM-së, e ka bazën e dokumentacionit se në çfarë baze do të vazhdojë kjo procedurë në mënyrë që pastaj të vëhet në shqyrtim publik, në rast se nuk e ka përgatitur materien mirë atëherë ne kthehemi në pikën zero ashtu siç kemi biseduar herën e fundit, andaj duhet të jemi të kujdesshëm në këtë pikë sepse kjo është në përgjegjësinë dhe kompetencën e Ekzekutivit dhe nuk është punë e Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim propozimin e këshilltarit z.Rafet Llapashtica që të hiqen nga rendi i ditës dy pikat e propozuara nga ai, dhe atë; *1-Propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste, dhe 2- Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021.*

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se vetëm 7 vota janë PËR, dhe rrjedhimisht nuk kalon propozimi për heqjen e dy pikave nga rendi i ditës për këtë seancë (propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste; dhe propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale të komunës së Podujevës)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje dhe konstatimeve të rekomanduara nga KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 10 vota PËR, asnjë KUNDËR, dhe 15 vota të PËRMBAJTURA, miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 24 shtator 2021, në kuadër të të cilit përfshihet edhe pika shtesë, dhe atë;

- *Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021 (e cila renditet në pikën 7 të rendit të ditës, ndërsa pika Të ndryshme kalon në pikën 8)*

**1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:
28 qershor 2021 dhe 30 korrik 2021**

z.Mehmet Gashi, theksoi, kam vërejtë një vërejtje në procesverbal, nuk e di si ka ndodhur mirëpo kërkoj që të korrigjohet. Në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të dt. 28.06.2021, në fillim të faqes nr.11, kemi vërejtur një gabim teknik por edhe në formulim të fjalisë që kam dashur ta them, prandaj kërkoj që ky gabim të korrigjohet dhe duhet të jetë kështu; si kriter kryesor të ndarjes së buxhetit për komuna ka qenë numri i banorëve me 89%, Komuna e Podujevës pas luftës është vlerësuar se ka 117000 banorë, ka dalë si Komuna e tretë pas Prishtinës dhe Prizrenit, kurse pas regjistrimit të vitit 2011, ka dalë Komuna e 7 me 87546 banorë, andaj konsideroj se këtu është një gabim dhe kërkoj që të korrigjohet.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohen procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës, përfshirë kërkesën e këshilltarit z.Mehmet Gashi për korrigjim të diskutimit në procesverbalin e datës 28 qershor 2021, riformulim në pjesën e parë në faqen 11.

2. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, sot në këtë seancë të fundit të kësaj asambleje komunale rrjedhimisht është votimi për një nga dokumentet më të rëndësishme të cilat i miraton asambleja komunale, përkatësisht buxhetin për vitin 2022, si dhe projeksionet buxhetore për vitet 2023-2024. Buxheti i Komunës së Podujevës në bazë të Qarkores së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave është 23,449,521.00€, Qarkore e cila i përcakton edhe kufijtë mes kategorive buxhetore. Komuna e Podujevës ka buxhet për paga 12,470,000.00€, mallra dhe shërbime, 2,650,000.00€, për shpenzime komunale 420,000.00€, për subvencione 960,000.00€, për shpenzime kapitale 6,949,521.00€, pra në total 23,449,521.00€.

Ky projektbuxhet është hartuar në bashkëpunim dhe në diskutimet publike të cilat i kemi bërë edhe me qytetarët, janë ndjekur të gjitha procedurat dhe ka pasur shumë diskutime dhe kërkesa të përditshme nga ana e qytetarëve të cilat i kanë marrë Drejtoritë përkatëse. Gjithashtu për këtë buxhet janë ftuar edhe grupet e këshilltarëve të asamblesë komunale që të japin kontributet e tyre me propozimet e tyre konkrete për hartimin e këtij buxheti. Buxheti për vitin 2022, i është kushtuar rëndësi dhe i është dhënë prioritet disa programeve siç është çështja e arsimit ku kemi një rritje të theksuar të buxhetit në arsim, dihet që buxheti për arsim përcaktohet nga granti specifik për arsim, mirëpo përveç grantit specifik për arsim i cili është minimumi i buxhetit të arsimit Komuna e Podujevës dhe çdo organizatë tjetër buxhetore dhe çdo komunë ka mundësi me rritë këtë buxhet nga granti i përgjithshëm apo nga të hyrat vetanake dhe këtë e ka bërë Komuna e Podujevës, shembull kemi infrastrukturën shkollare ku nga 97,582.00€ që ka qenë, për vitin 2022 kemi një buxhet 444,218.00€, që ka një rritje prej 4.5 %, gjithashtu rritje kemi edhe në kategorinë e mallrave të çështja e arsimit ku janë disa projekte të cilat ne i konsiderojmë shumë të rëndësishme për funksionimin e institucioneve arsimore, bëhet fjalë për furnizim me pajisje në vlerë prej 170,000.00€, furnizim me kabinete si dhe është parashikuar për herë të parë programin për shujta të nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e pestë, që përcaktohet me Qarkore Buxhetore me një vlerë 206,355.00€, po ashtu rritje të buxhetit i kemi kushtuar edhe në sektorit të shëndetësisë për disa

kategori siç është pozicionet për renovimin e objekteve shëndetësore ku kemi dyfishim të mjeteve buxhetore nga 50,000.00€ në 100,000.00€, pastaj rritje kemi te subvencionet për shëndetësi nga 70,000.00€ në 100,000.00€.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar investimeve në kulturë ku kemi një rritje të buxhetit te investimet kapitale nga 223,550.00€ në 355,000.00€, në subvencione kemi një rritje të lehtë sepse nuk kemi pas mundësi të kemi rritje më të madhe buxhetore për shkak të limiteve buxhetore të cila përcaktohen në kategorinë e subvencioneve, gjithashtu edhe në mallra dhe shërbime ka një rritje prej 2.9% në fushën e bujqësisë. Zhvillimit ekonomik i është kushtuar një vëmendje e veçantë ku shpenzimet kapitale janë rritur 9.9%, për vitin 2022, pra investime prej 270,000.00€ në krahasim me 140,556.00€ që kanë qenë në vitin 2021, si projekte janë për zonat ekonomike që janë ndër projektet më të rëndësishme që ka Komuna e Podujevës, gjithashtu parashihen subvencione për bizneset prodhuese përkatësisht subvencionimin e normave të interesit për biznes prodhuesit nga investimet të cilat ata i bëjnë. Projektet kapitale nga DPUMM dhe nga materialet që keni marrë të nderuar asamblist mund të shihni se janë paraparë projekte shumë të rëndësishme për zhvillimin e Komunës së Podujevës, siç është rikonstruksioni i rrugëve. "Skënderbeu" dhe "Xhemajl Mustafa" me infrastrukturë përcjellëse, ndoshta një dallim është që në raport me KAB që është paraqitur te ky projekt është e mundur të vërehet një ulje e dyfishtë dhe arsyeja pse ka ndodhur kjo është se do të ketë bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës që do të participoj në shumë prej 700,000.00€, gjithashtu ndërtimi i rrugës së xhamisë që lidhet me magjistralen Podujevë-Prishtinë në vlerë 730,000.00€, si dhe projektet tjera në lagjet dhe fshatrat e Komunës së Podujevës.

Kjo ishte një paraqitje e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Podujevës, unë i ftoj të gjitha Grupet e asamblistëve që ta mbështesin këtë buxhet në mënyrë që të kemi miratim të buxhetit dhe qeverisja e re komunale ta gjej këtë buxhet të miratuar. Normalisht çdo buxhet nga qeverisja e re nga cilido subjekt që vjen mund t'i bëjë ndryshimet përkatëse, qoftë me rishikime të buxhetit, rialokime të ndryshme dhe përmirësimet eventuale, kushdo që mund t'i vërej.

Miratimi i këtij buxheti e them me bindje të thellë dhe besoj se prezent këtu janë nga të gjitha Grupet e subjekteve politike dhe kanë përvojë të gjatë në qeverisjen komunale dhe e dinë se mos miratimi i këtij buxheti do të ketë pasoja negative për Komunën e Podujevës, andaj kam një shpjegim procedural për pasojat që shkaktohen me mos miratimin e këtij buxheti deri më datën 30 shtator 2021, rrjedhimisht Ministria e Financave e merr për bazë buxhetin e viti 2021, që është një buxhet prej 700,000.00€ më i ulët se sa parashikimi i buxhetit për vitin 2022, gjithashtu deri në konstituimin e institucioneve tjera të cilat dalin nga zgjedhjet lokale kur duhet të miratohet buxheti, këto tabela buxhetore duhet të shkojnë në Ministri të Financave e cila e voton dhe ia bashkëngjit buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës, meqenëse buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore e miraton Parlamenti i Kosovës, rrjedhimisht pastaj edhe këto tabela buxhetore nga Komuna e Podujevës duhet të shkojnë për miratim të posaçëm në Parlamentin e Republikës së Kosovës, për arsye se buxheti i konsoliduar votohet tani në muajin tetor dhe në rast se Komuna e Podujevës nuk e ka miratuar buxhetin atëherë miratimi i buxhetit do të shkojë në miratim të veçantë, kjo nënkupton se Komuna e Podujevës nuk do të ketë buxhet të miratuar deri në muajin mars. Pastaj buxheti i Komunës së Podujevës nëse nuk miratohet deri në muajin mars të vitit 2022, rrjedhimisht nuk mund të dorëzohet plani i prokurimit për vitin 2022 e që nënkupton se Komuna e Podujevës deri në muajin mars të vitit 2022 nuk mund të zhvillojë asnjë procedurë të prokurimit. Deri në muajin mars të vitit 2022 nëse nuk mund të zhvillohet asnjë procedurë e prokurimit de fakto viti 2022 do të jetë vit me deficit të theksuar buxhetor që është një humbje e pastër për Komunën e Podujevës. Ne e dimë që në vitin 2020 ka pasur një suficit buxhetor vetëm

prej grantit qeveritar afër 2,000,000.00€, besoj që qytetarët e Komunës së Podujevës nuk e meritojnë një gjë të tillë të ndodh edhe në vitin 2022.

z.Mehmet Gashi, theksoi, për shkak të shifrave më duhet që më shumë të lexoj, përndryshe e dini Kornizën Afatmesme Buxhetore që në muajin qershor nuk është miratuar nga Kuvendi i Komunës, për herë të parë pas lufte një dokument i tillë nuk miratohet nga Kuvendi dhe pothuajse të njëjtën Kornizë tani e ka sjellë Ekzekutivi për miratim. Ne i dëgjuam të gjitha pasojat që i ceku drejtori i DBF, mirëpo mundësitë ekzistojnë ende vetëm kërkohet të korrigjohet dhe të përmirësohet dhe kur s'kemi vërejtje ne e përkrahim. Sot në rend dite kemi një dokument mjaft të rëndësishëm, propozim vendimi për miratimin e projekt buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024. Propozim vendimi i buxhetit të komunës për vitin 2022, është i paraparë të jetë 23,449,521.00€ e që është buxhet më i ulët për 404,133.00€, se sa buxheti i vitit 2021, 22,93,305.00€, janë grant i qeverisë kurse 1,356,216.00€ janë të hyra vetanake, 12,470,000.00€, apo 53% janë për paga, 11.3% për mallra dhe shërbime 6,949,521.00€, për shpenzime kapitale apo 29.6%, 420,000.00€, shpenzime komunale, 960,000.00€, subvencione dhe transfere. Propozim buxheti prej 23,449,521.00€ ndahet sipas programeve apo sektorëve, administratë komunale 9,695,565.00€, shëndetësi 3,245,967.00€, arsim 10,507,989.00€, me qëllim që edhe qytetarët ta kenë më të qartë ndarjen e buxhetit sipas sektorëve dhe krahasimet me buxhetin e vitit 2021. Po përmendi këto shifra, në administratën komunale buxheti i propozuar për vitin 2022 është 9,659,565.00€, apo për 1,200,118.00€ më i ulët se sa në vitin 2021, sipas përqindjes llogaritet 10.9%, pastaj në sektorin e arsimit buxheti është 10,507,989.00€, apo për 745,985.00€ e që i bie 7.5% më i lartë se sa në vitin 2022, kurse vetëm 1% më i lartë se sa buxheti për vitin 2022 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 21 shtator 2020. Në sektorin e shëndetësisë propozim vendimi për buxhetin 2022 është 3,245,967.00€ apo 50,000.00€ më shumë se në vitin 2021, kurse më i ulët për 953,293.00€ se sa me projeksionet e miratuara në Kuvendin e Komunës për vitin 2022, që në bazë të llogaritjes i bie rreth 30% më pak.

Të gjitha këto shifra i theksoi sepse para këshilltarëve dhe opinionit po flitet se buxhetin e paraparë për vitin 2022 e kemi rritur në arsim për 5 herë, në shëndetësi për 5 herë që i bie 500%, pra nëse keni menduar që kjo rritje ka ndodhur te mallrat dhe shërbimet apo te investimet kapitale sepse edhe kjo nuk qëndron nëse e krahasojmë këtë propozim buxhet për vitin 2022, me buxhetin e miratuar në vitin e kaluar. Në arsim, te mallrat dhe shërbimet kemi 542,264.00€ të miratuara kurse 928,650.00€ të propozuara, te investimet kapitale është e kundërta 982,055.00€ të miratuara vitin e kaluar për vitin 2022, kurse të propozuara janë 594,218.00€, mandej në shëndetësi për shpenzime kapitale të miratuara për vitin 2022 kanë qenë 1,522,949.00€ të propozuara, kurse tani janë 650,931.00€.

Duke u bazuar në dokumentet zyrtare për buxhet, propozim vendimi për projektbuxhetin e Komunës për vitin 2022 është më i vogël për 404,133.00€ se sa buxheti i vitit 2021, për të gjitha këto jemi bazuar në dy dokumentet buxhetore të vitit të kaluar të datës 01.09.2021 dhe propozim buxheti për vitin 2022 sot që e kemi para veti. Duke ditur që komuna nuk ka mundësi ligjore ta rrisë buxhetin për paga por mund të bëjë lëvizje të vogël te mallrat dhe shërbimet apo te investimet kapitale në përputhje me kufijtë buxhetor që i ka caktuar Qeveria për komuna, kam një pyetje, Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, në fushatën e kaluar zgjedhore për 1465 punëtor në sektorin e arsimit, ka premtuar shujtën e ngrohtë me nga 2€, andaj kur ndahen nga 2€ për 1465 brenda një viti llogariten rreth 500,000.00€, pyetja ime është se ku janë paraparë këto mjete, lëre më të flasim për vendimin e Gjykatës për ankesat e tyre prej vitit 2017 që llogaritet rreth 2,500,000.00€.

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit, Ekzekutiv dhe të gjithë të pranishmit këtu, tani dëshiroj të ndalem edhe për investimet kapitale të parapara për vitin 2022. Më datë 28.06.2021 në Kuvendin e Komunës si pikë e rendit të ditës ishte edhe propozim Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së

Podujevës për vitet 2022-2024, dokument për të cilin kemi pasur vërejtje te projektet prioritare, gjithashtu kemi propozuar edhe disa projekte që kemi menduar se janë në interes të qytetarëve, Vërejtje kemi pasur edhe në projektet e infrastrukturës publike sidomos për DPUMM-në dhe DSHPMSh-në. Në DPUMM nga 22 projekte vetëm për dy projekte dihet se në cilën rrugë bëhet investimi, kurse të gjitha tjerat janë të përgjithësuara si asfaltim i disa rrugëve në qytet, asfaltim i disa rrugëve në fshatra, gjithashtu edhe në DSHPMSh-në kemi vërejtur se për vitin 2022 qartë nuk ka paraparë ndërtim të kanalizimit por ka paraparë shumën 40,000€ vetëm mirëmbajtje edhe pse nevojat ende janë të mëdha qoftë edhe në qytet siç është rr.”Kongresi i Manastirit”, prandaj emërtimi i projekteve duhet të jetë i saktë, emri i rrugës, vendi etj. që të ketë transparencë për qytetarët gjë për të cilën kur ishin në opozitë këshilltarët e LVV-së kanë kërkuar, mirëpo asnjëherë nuk e kanë përkrahur buxhetin e propozuar nga ish Ekzekutivi, andaj edhe ne mendojmë për faktin që nuk merren parasysh vërejtjet tona të cilat i kemi bërë edhe kur kemi shqyrtuar në muajin qershor KAB 2022-2024 e cila nuk është miratuar në këtë Kuvend kurse tani Ekzekutivi ka sjellë pas 3 muajsh po në këtë Kuvend propozim vendimin për projektbuxhetin e Komunës për vitin 2022 dhe projeksionet për vitet 2023/2024 pa asnjë ndryshim, prandaj ky është një injorim për Kuvendin dhe përgjegjësia për mos miratim të buxhetit i bie Ekzekutivit.

znj.Lirika Maliqi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së, theksoi, projektbuxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024, është një ndër dokumentet më të rëndësishme për miratim në Kuvendin e Komunës, për dallim prej herëve të kaluara në këtë projekt buxhet vërehet prioritetizimi i sektorëve me rëndësi për ato çka Grupi i këshilltarëve të LVV-së vazhdimisht e ka ngritur zërin në këtë Kuvend. Orientime u është bërë ngritjes së investimeve në sektorin e arsimit, shëndetësisë, kulturë, bujqësi dhe zhvillim ekonomik, pa dyshim kjo e bënë më të rëndësishëm këtë dokument se ajo çfarë jemi mësuar të shohim deri më tani, andaj Grupi i këshilltarëve të LVV-së është për miratimin e këtij projektbuxheti.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, theksoi, ky buxhet nëse dështon, dështon konkretisht si shkak i mos punës së drejtorit të DBF-së dhe Kryetarit të Komunës. Drejtori i DBF-së deklaroi se i kam ftuar Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike për diskutim për hartimin e buxhetit për vitin 2022. Për KAB i ka ftuar Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike sepse ka qenë edhe përfaqësuesi i PDK-së z.Fatmir Rudari në atë takim që ka dhënë propozimet dhe mendimet e tij për KAB-in, mirëpo sa i përket projektbuxhetit që keni sjellë tani për miratim, Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike nuk i keni ftuar, të paktën po flas për Grupin e këshilltarëve të PDK-së, përkundër faktit që e dini se KAB nuk është miratuar, keni marrë rekomandimet dhe mendimet tona, mirëpo asnjë rresht nuk e keni përmirësuar, ose nuk ju ka punuar kompjuteri ose nuk keni shkuar në zyrën tuaj që t’i bëni ato ndryshime, ose nuk keni dëshiruar ju drejto i DBF-së dhe Kryetari i Komunës. Unë e kuptoj pozitën e juaj që udhëhiqni Ekzekutivin dhe dëshironi të punoni ashtu siç dëshironi ju sepse mendoni se është më mirë dhe ndoshta nuk e dini se jeni duke punuar keq dhe gabueshëm, por buxheti si shkak i mos punës tuaj apo injorimeve politike nuk miratohet sot.

Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi e ka hequr nga investimet e vitit 2022 shkollën e fshatit Obrançë, kurse unë e kam përcjellë Kryetarin në debatet televizive të muajit shkurt para se të vije në detyrën e Kryetarit, dhe është mirë që t’i merr ato fotografi që e merrte shembull shkollën e fshatit Obrançë (edhe pse nuk vij nga ai lokalitet) i shikonte poçet elektrike dhe “bërtitke” deklaronte në TV duke paraqitur fotot dhe duke kritikuar pushtetin se si është bërë ajo shkollë, Kryetar i cili ka qenë për 8 vite drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, kurse tani investimet e shkollës së fshatit Obrançë i ka adresuar në fshatin Llugë. Shumë qejf kam pasë që të bëhet ndryshimi sepse ish Kryetari z.Agim Veliu investimet i ka dërguar në fshatin Bradash, ndërsa ky tani zotëri Bulliqi

investimet i dërgon në fshatin Llugë, e them këtë sepse e ka larguar nga buxheti i paraparë për vitin 2022 investimin e ndërtimit të shkollës së fshatit Obrançë. Ndoshta ne e votojmë këtë propozim vendim të buxhetit por është mirë që drejtori i DBF-së, meqë Kryetari i Komunës mungon në këtë seancë e që prezentë është Nënkryetarja e Komunës, të dal dhe të deklarohet dhe t'ju tregoj banorëve të fshatit Obrançë përse e kanë larguar nga projektbuxheti ndërtimin e shkollës në Obrançë sepse ata ju kanë votuar dhe si subjekt politik që jeni LVV që keni fituar me shumicë të votave në fshatin Obrançë. Ndryshimi ka ndodh për shkak të keqqeverisjes, kurse të thoni ne e kemi heqë prej buxhetit ndërtimin e shkollës në fshatin Obrançë dhe për këtë duhet të deklaroheni përse e keni heqë dhe përse e keni dërguar në fshatin e Kryetarit në Lluga, por jo të kërkonin vota këtu brenda Kuvendit. Pastaj premtim i Kryetarit ka qenë zbatimi i kontratës kolektive të arsimit, por tani të del drejtori i DKA-së t'ju tregoi mësimdhënësve dhe sektorit të arsimit se për kontratën kolektive nuk është parashikuar asnjë cent në projektbuxhetin e vitit 2022, pra ka paraparë shujtën për nxënës por jo edhe për profilin e arsimit, pra këtë duhet ta dinë profesorët, arsimtarët dhe mësuesit që nga Çerdhja e deri në Gjymnaz që nuk ka asgjë në parashikimet buxhetore të vitit 2022 për këto kategori në, pra e them që të dihet botërisht pastaj ata të vendosin si të veprojnë ngase i nderuar Kryesues për ata po vendosim ne këtu si Kuvend, thënë ndryshe, për moszbatimin e asaj kontrate të përgjithshme këtu po vendosin këta 35 persona/anëtar të Kuvendit që jemi, shtrohet pyetja, kush jemi ne të vendosim për rreth 1800 mësimdhënës që mos t'iu realizohen të drejtat sipas kontratës kolektive. Kërkoj nga ta gjeni buxhetin dhe t'ju japin mjetet buxhetore që i'u takojnë atyre sepse unë nuk jam mësues e as profesor dhe nuk i marrë ato mjete, mirëpo Komuna e Podujevës ka mjete buxhetore për këtë çështje. Komuna e Drenasit ka më pak mjete buxhetore se sa Komuna e Podujevës dhe ka dy vite që e zbaton kontratën kolektive dhe mësimdhënësit i marrin pagat, madje përkundër faktit që Komuna e Drenasit i ka të hyrat vetanake më të vogla se Komuna e Podujevës, kurse tani nëse i falë borxhet e atyre bizneseve të pa përgjegjshme “kapadaive” me këtë propozim për falje të borxheve që keni sjellë sot do të mund ta zbatonit kontratën kolektive. Kërkoj të na tregoni sot sa është shuma e faljes së borxheve të atyre bizneseve të pa përgjegjshme – “kapadaive” që unë po i quaj, dhe sa janë pagesat e atyre biznese serioze që i kanë kryer kontributet e tyre për Komunën lidhur me taksën në fjalë. Pra mjetet buxhetore unë ua gjej vetëm ju duhet të jeni të vendosur për zbatimin e kontratës kolektive për arsim.

Ky propozim buxhet kështu nuk mund të kaloj, arsyeja e potencuar se Komuna e Podujevës do të mbesë keq për shkak të mos miratimit të buxhetit deri në muajin mars, të gjitha këto arsye janë përralla. Arsyeja se Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë me miratuar buxhetin e komunës pastaj, mund të them se ata punë e kanë atë çështje dhe nuk janë aty vetëm sa për të nderjtë por kanë përgjegjësi 10 herë më të madhe se një asamblist i një Kuvendi komunal, mirëpo nëse mendon Kuvendi i Republikës së Kosovës se një Komunë me afro 100 mijë banorë do të mbesë keq, ata duhet të mblidhen, dhe jo vetëm sipas qejfeve të tyre për të marrë mëditjet apo çështje tjera të ngjashme, sepse aty nuk është në pyetje kush është Kryetari i Komunës, por ka përgjegjësi institucionale ngase të gjithë po sillemi rrugëve për të kërkuar votë për zgjedhje lokale dhe ato qendrore dhe në një formë po bëjmë shaka në dhoma të ngushta dhe salla të debateve, kurse në rrugë diçka tjetër folët.

Pras Komuna e Podujevës që mbetet pa miratim të buxhetit, pastaj nuk mund të vijë një Kryetar dhe të arsyetohet se një Kryetar tjetër e ka lënë buxhetin siç ishte në këtë rast ish Kryetari Agim Veliu me LDK-në, dhe të arsyetohet mandej duke thënë vazhdimisht se unë nuk di se çfarë të bëjë për një vit e gjysmë, pra nuk dua ta dëgjoj Kryetarin e ardhshëm duke u ankuar për këtë buxhet të cilin ti ia len kështu në këtë formë në rast se miratohet, por dua ta shohë një Kryetar i cilit do subjekt qoftë, që bënë zgjidhje për problemet, mirëpo tani ne ish shefin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së z.Avni Fetahun nuk mund ta padisim në Gjykatë përse në atë kohë insistonte të jetë ashtu buxheti i vitit

2021, buxhet për të cilin tani ankohet Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi e që në atë kohë unë kam thënë se nuk bënë kështu, por këta thoshin bënë, ndërsa tani zotëri Fetahu së bashku me Kryetarin “qajnë me mindil dhe i fshijnë lotët” duke u ankuar se LDK-ja ma ka trashëguar këtë buxhet, e që sërish po e përsëris se unë kam qen kundër miratimit të atij buxheti, mirëpo propozimi im nuk është marrë për bazë dhe shumica e këshilltarëve kanë votuar, konkretisht 15 këshilltar të LDK-së së bashku me z.Avni Fetahun si shef Grupi kanë vendosur për 87000 banor, për 1800 profesor, 800 infermier, 800 agronom, për gjitha rrugët, ujërat dhe gjitha projektet tjera, prandaj nuk ka çfarë ankohet askush tani sepse ashtu është votuar, prandaj kështu ky buxhet nuk kalon tani.

U fol për kulturën, pyes ku është Biblioteka e Vetëvendosjes, ku është paraparë të ndërtohet me 100,000.00€, në cilën pronë e që është dashtë drejtori të kërkon t’ia miratojmë duke arsyetuar se janë planifikuar 100,000.00€ për ndërtimin e Bibliotekës së qytetit duke specifikuar edhe pronën se ku do të ndërtohet ngase qytetarët, nxënësit dhe studentët duan të dinë se ku do të lexojnë, paramendoni të mos e ndërtonte BE objektin e Komunës, nuk do të kishte Bibliotekë fare sepse nuk mundemi në vitin 2021 t’iu themi shkoni lexoni nëpër korridore apo podrume të objekteve të ndërtuara në kohën e Titos sepse nuk është zgjidhje ajo, prandaj nuk mund të flitet për kulturën këtu dhe të thuhet se të akuzohemi ne gjoja po e bllokojmë buxhetin për kulturë ngase për ato shuma të mjeteve 800,000.00€ apo 1 milion euro duhet të sqarohen dhe arsyetohen pastaj unë jam ai i pari që do ta ngrisë dorën për këtë buxhet dhe pse jam opozitë.

Pastaj janë paraparë 250,000.00€ për furnizim me mobilje dhe blerjeve të mallrave në arsim dhe shkencë, andaj kur unë votoj për këtë shumë dhe këto mallra normal që dua ta di edhe çka do të blihet (ngase po të kërkohej ty drejtor i DKA-së vetëm 250€ prej parave tua për një shkollë menjëherë të ngrihet dora dhe nuk të hyn në xhep), dhe tani nuk mund të qajmë dhe ankoheni askush për gjendjen e rëndë të shkollave të z.Shpejtim Bulliqit, dhe t’jua miratojmë këto 2 milion euro, pastaj keni blerë Televizorë në pandemi kurse asnjë nxënës nuk është në shkollë që të mësojnë mësimin online andaj kush i ka shikuar ata televizorë kur shkollat kanë qenë të mbyllura që një vit e gjysmë, a shpenzohen 2000€ për një televizor, më mirë do të ishte që fëmijëve / nxënësve t’iu blehen laptop ngase mësimin online nuk e ka përcjellë gjysma e arsimit në Podujevës dhe për këtë jam në dijeni e lëre më vende rurale. Prandaj qeverisja bëhet ndryshe dhe votë për që të miratohet buxheti me rreth 25 milion euro, apo për 4 vite rreth 100 milion euro për t’i futë në punë në këtë Komunë për paga dhe investime, ai dokument nuk mund të kalojë në atë formë fare, kushdo që është në pushtet unë këtë diskutim dhe mendim e kam sepse nuk kam përgjigje qoftë këtu në foltore qoftë në dokumente, dhe në këtë aspekt nëse mund të më jepni përgjigje dhe specifikime për 250,000.00€ e 300,000.00€ për rrugë vetë drejtori i cili e ka planifikuar buxhetin për cilindo fshat, sepse unë mund ta di se për ku janë planifikuar ato mjete, madje nuk e din as drejtori përkatës si propozues.

Kështu që për të kaluar me vota ky dokument i projektbuxhetit, të tregoj drejtori i DKA-së e që në këtë rast është dashtë Kryetari të jetë këtu, përse është heq nga projektet shkollë e fshatit Obrançë dhe është dërguar në fshatin Lluga për të cilin nuk jemi kundër që të ndërtohet, por përse është heqë ajo e fshatit Obrançë, e them këtë sepse po harron pastaj ato letrat e fotot e debateve kur Kryetari i Komunës i paraqiste me zë të lartë dhe me foto si probleme (shkollë e Obrançës, poçet elektrike) dhe tani të del të na tregoj përse e ka heqë nga projektet shkollën e fshatit Obrançë dhe po e ndërton shkollën e fshatit Lluga, por jo vetëm të sjellët këtu projektbuxheti për votim dhe të kërkohej votë për këtë duke mos e thirr askënd për konsultime drejtori i DBF-së edhe pse i ka marrë rekomandimet se çfarë kërkojmë të ndryshohet në këtë projektbuxhet dhe pyes përse nuk i ke ndryshuar ato çështje mirëpo tani përkundër asaj ju as përgjigje dhe sqarime nuk jepni.

Sa i përket asaj se a mbetet Komuna e Podujevës keq me mos miratimin e buxhetit, unë pyes drejtorin e DBF-së, në cilin muaj kanë filluar procedurat e prokurimit në këtë vit, e që unë mendoj se

asnjë procedurë nuk ka filluar para muajit mars dhe këtë po e bazoj në përgjigjet tuaja kur po ju pyesim përse nuk po ecë dinamika e investimeve dhe punimeve ju po thoni procedurat e prokurimit kanë filluar pas muajit mars, prandaj për që mbetet Komuna e Podujevës keq nga mos miratimi i këtij buxheti, unë ju them se jo sepse vet ecin punët (sikurse automjeti në ler), dhe që ju mendoni se do t'ju rritet dinamika atëherë duhet të merren tjera vendime.

Kështu që Grupi i këshilltarëve të PDK-së, kështu siç është nuk e voton projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023/2024 dhe i japëm arsyet, madje z.Shpejtim Bulliqi në këtë seancë ka dashtë ta sjellë edhe një pikë të rendit të ditës, por të njëjtën e ka tërheqë sot në mëngjes dhe fjala ka qenë për ndërtime të shtëpive të banimit sipas fondacionit të Elvis Naçi, mirëpo ju mendoni se na vetëm rrimë, por për atë pronë ku ka planifikuar Kryetari atë projekt ka kërkesë që ajo të jepet në shfrytëzim, prandaj me atë fondacion dhe atë marrëveshje me atë organizatë të nënshkruar nga Kryetari i juaj sepse mua nuk mund të më përfaqësoj në atë formë, dhe me ato veprime nuk mundet sepse nuk lejoj e një gjë të tillë, shtëpitë sociale mund t'jua ndërtoni atyre personave që kanë nevojë, por në pronat e tyre, fondet i keni nga ai fondacion, urdhëroni ndërtoni shtëpitë sociale në prona private, kurse pronën e planifikuar për këtë çështje jepen në shfrytëzim dhe rritni të hyrat komunale, kështu që lëreni këto marifetllëqe por vazhdoni me punë sepse për atë edhe e keni marrë besimin e qytetarëve për t'iu krijuar kushte më të mira.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, buxheti i Komunës jo vetëm që është më i rëndësishmi por është jetik për funksionimin e Komunës, t'ju them të drejtën në shumë raste përdoret edhe për qëllime të fushatave elektorale por para së gjithash do të duhej të ishte një platformë përmes së cilës paraqiten prioritetet në mënyrë sa më reale të mundshme për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, pra për të gjithë pa dallime, dhe kur e them tek përcaktimi i prioritetëve, vlen të ceket vetëm një nga rastet që ishte ndërtimi i shkollave kur dihet se sa prioritare është ndërtimi i shkollave, jo vetëm në fshatin Obrancë por edhe në fshatin Dumosh ashtu siç ka qenë e projektuar edhe në buxhetin e paraparë në vitin e kaluar.

Përveç kësaj, një përpjekje për t'i hamendësuar qytetarët dhe për t'i vetëkënaqë në momente të tilla çfarë ndodhemi tani është edhe përcaktimi i projekteve nëpër grupe të mëdha, e kemi rastin ku thuhet asfaltimi i disa rrugëve lidhëse Buricë, Kunushec, Llaushë, Dobërdol, Dumosh, Sfeçël, Kaçybeg, Siboc, pastaj edhe më e palogjikshme është grupimi i fshatrave që madje nuk janë as afër siç është rasti ku thuhet asfaltimi i disa rrugëve në Repë, Brecë, Shtedim, do të thotë nga një pikë andej tek pjesa tjetër e kufirit. Nuk e kam dertin shumë të madh që kemi këso grupimesh të mëdha të fshatrave, por ajo çka na brengosë është fakti që një grupim i tillë lejon mundësinë që në të ardhmen në bazë të prioritetëve jo reale apo në bazë të preferencave që mund t'i ketë pushteti pra ta merre një projekt nga një fshat dhe ta përcakton tek tjetri fshat dhe pastaj t'ju thuhet qytetarëve po jeni në këtë grup të projekteve, por së pari po shkojmë andej e pastaj këndeje. Këtë nuk po e them vetëm se po mund ta them, por po e them me fakte, jeni në dijeni shumë mirë se në buxhetin aktual të miratuar në vitin e kaluar ka qenë e paraparë të ndërtohen 4km ndriçim në fshatin Sfeçël dhe çfarë ndodh sot është akoma më keq, jo që nuk ka filluar fare por ka filluar njëherë dhe pastaj është tërhequr ndriçimi publik e që konsideroj se kjo është një tallje për banorët e atij vendi dhe unë kërkoj sqarim për këtë çështje.

Çështje tjetër të cilën po e potencoj ka të bëjë me faktin që nuk e kuptoj si ky Ekzekutiv ka të drejtë të kërkoj votën tonë në Kuvend, e personalisht votën time kur dihet se këta nuk e kanë përfshirë shumën e caktuar për kompensimin e dëmeve në bujqësi, tash 1 vit të gjithë kolegët e dinë se unë bashkë me disa kolegë të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e kemi sfiduar edhe subjektin tonë politikë sa ishte në pushtet me të vetmin qëllim që të përfshihet kjo shumë në kuadër të buxhetit dhe

patëm arritur që ta përfshijmë një shumë prej 86,000.00€ në rast të dëmeve të shkaktuara në bujqësi që të bëhet kompensimi i menjëhershëm për bujqit kur dihet se sa rëndësi të madhe ka ky sektor për të gjithë ata qytetarë tanë të vyer që mbajnë familjet e tyre me këtë sektor, pra në momentin kur unë e pata sfiduar subjektin tim politik në foltore të Kuvendit të Komunës, të gjithë kolegët e mijë opozitar e patën duartrokitur dhe më patën motivuar për atë gjest, e me theks të veçantë më të zëshmit kanë qenë kolegët këshilltarë nga radhët e LVV-së, ndërsa sot kemi një buxhet në të cilin nuk janë lodhur fare ta përfshijnë atë shumë, prandaj për këto arsye e sidomos për këtë të fundit, ky propozim buxhet për LDK-në dhe për mua personalisht është i papranueshëm dhe i pakalueshëm.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kritika pa alternativ është dështim, ne tani të nderuar gjendemi para dy alternativa, 1-ne po kthehemi në mentalitetin e vjetër politik dhe të ngulitemi në atë idiotizmin e vjetër politik t'i mbrojmë interesat tona të subjekteve tona politike...

Kryesuesi i Kuvendit, tërheqë vërejtjen për fjalorin dhe shprehjet e përdorura nga këshilltari z.Ragip Fetahu, dhe njëkohësisht kërkon të mos përsëriten shprehje të tilla duke shtuar që pastaj jam i detyruar të reagoj ndaj secilit.

z.Ragip Fetahu, vazhdoi, pra isha duke fol për interesa tona politike në këtë periudhë fushate zgjedhore në të cilën ne gjendemi, apo 2-ti mbrojmë interesat e qytetarëve duke përkrahur dokumente jetike të cilat e trasojnë rrugën e qytetit tonë. Pra mendoj që me sa vërejtja nga fjalimet e kolegëve/eve jemi kthyer sërish në atë mentalitetin e vjetër politikë, mentaliteti i cili fatkeqësisht nuk na dërgon përpara e që është për të ardhur keq ngas prej se jam anëtar i këtij Kuvendi kam parë një korrektësi dhe një racionalitet të të gjithë kolegëve mirëpo tani me fushatën zgjedhore që ne gjendemi ka ndryshuar kjo qasje. Prandaj mos aprovimi i këtij projektbuxheti është një dështim i joni si këshilltar të Kuvendit të Komunës së pari, një dështim i opozitës e cila pretendon ta merr pushtetin sepse këtu shihet qartë që nuk e mbron interesin e qytetarëve por mbron interesat politike të subjekteve të tyre.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk pata ndërmend të diskutoj sërish për këtë dokument, mirëpo nganjëherë fjalimet po ndikojnë të kërkoj fjalën sërish. I nderuari Ragip Fetahu, ju mbajtët një fjalim politik, por për t'i mbrojtur interesat e bujqve duhet të parashihen mjete buxhetore sepse (me një faleminderit mbetet vetëm morali dhe xhepi bosh). Komisioni përkatës i ngritur nga Kryetari i Komunës e ka sjellë shumën e dëmeve në bujqësi, prandaj për burrin dhe për mbrojtjen e interesave të qytetarëve Zoti mos na provoftë. Për të mbrojtur qytetarët duhet të dalësh ndryshe edhe nga i juaji kur e ka keq dhe këtë fute në kokë (ti Ragip je më i ri në moshë por duhet të jeni më i ngulit mos me të lëkund asnjë erë në atë drejtim). Për të mbrojtur bujqit dhe agronomët ju e keni më të lehtë sepse i keni drejtorët e juaj si subjekt politik, mirëpo ne këtu nuk e kemi ndërmend ta përfundojmë këtë seancë vetëm ashtu “shkel e shko” por do të diskutojmë deri në fund andaj mund t'i sjellni dokumentacionet dhe shumën e vlerësimeve të dëmeve nga Komisioni për plantacione dhe të ngjashme në komunën e Podujevës, dhe ne presim këtu e i analizojmë bashkërisht, dhe për këtë pyes kolegun, a jeni në dijeni sa është shuma e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Podujevës dhe këtë duhet ta dini ju si anëtar i Kuvendit nga i njëjti subjekt që udhëheqë me Komunën, madje ai komision është dashtë të jetë i përbashkët nga Kuvendi dhe Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, komisione të tilla këto të cilat funksionojnë në mënyrën duke dhënë vlerën minimale të dëmeve duke shkuar nga ajo që nuk ka mjetet të mjaftueshme buxhetore për kompensim, jo sa është realisht. Kështu që me deklarata të tilla siç ishte ajo e parafolësit nuk mund ta shtyjme parapara këtë dokument buxhetor. Pra një gjë të tillë duhet ta kërkonti ti vet personalisht i nderuar koleg ngase ne i kemi kërkuar rreth 270,000.00€ për kompensim të dëmeve në bujqësi dhe fusha tjera, nëse nuk ndodhin dëme mjetet mbeten në fondin e Komunës.

Pastaj parafolesi e tha që nuk ka alternativ, mirëpo duhet ta dijë ai se si të kërkohen ato mjete, unë po ju tregoj por ju dilni me Grupin e juaj këtu në foltore dhe përkraheni, duhet ta dini sa i keni të hyrat vetanake që nuk mund të shkojnë suficid buxhetor dhe vetëm mbeten në atë fond deri sa t'i ndaj Kryetari pastaj, prandaj e them se ndaj 250,000.00€ për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi, nëse nuk ndodhin dëme ato mjete pastaj i alokon diku tjetër, nëse ka shpërndani tek bujqit, pra unë po të tregoj si dhe në çfarë mënyre, po i tregoj edhe drejtorit se ku mund t'i merr mjetet e që edhe 50 vite mund t'i mbash ato mjete në atë fond, ngjashëm sikurse mjetet që ndodhen në fondin e projektit për "Vrellën e Revuçit", prandaj e them se mjete ka por vetëm duhet të ndahen, por jo me diskutime të tilla sikurse që ishte parafolesi zotëri Fetahu duke përmendur shprehje të tilla siç ishte "idiotizmave të vjetër" e që për mendimin tim i takojnë sistemeve të kaluara të vjetra, sisteme të cilat i kemi luftuar dhe i kemi heq nga këtu dhe këtu në Kosovë nuk mund të bëjnë ndokush çfarë të dojë, mund të bëjë në një periudhë të caktuar por jo çfarë të dojë sepse edhe në KPF e potencova se këtu në Kosovë atëherë që ndokush mënon ta shtrëngoq aq fortë, atëherë "këputet peni", ashtu siç është këput i atyre që i kemi mbrapa andej kufirit – Serbisë. Pra këtu Kosova qejfet e askujt nuk i dëgjon, kështu që i nderuar Ragip me ato terminologji nëse mendon të vazhdojë gjatë, me i respektuar qytetarët duhet të dini të respektoni edhe atë që mendon ndryshe, përndryshe duhet të rrugëtoni në një vend ku ka mendësi politike tjetër, prandaj i nderuar koleg Ragip Fetahu unë nuk po dëshiroj të këshilloj ty sepse nuk je që nuk ke shkollim, mirëpo me fjalime të tilla proceset nuk mund t'i shtysh përpara, por vetëm kthehen sërish prapa, kështu që ne nuk jemi këtu për t'u shtyrë mes vete dhe nuk dola këtu të shtyhem personalisht me ju Ragip, por ju e potencuar se po bëhen pengesa apo bllokime pa alternativë, ndërsa unë ju tregova alternativën, vetëm konsultohuni me drejtorin e juaj të Buxhetit dhe Financave, pyeteni sa janë të hyra vetanake, ndaj 250,000.00€ për kompensim të bujqve, mjete të cilat nuk shkojnë suficid por mbeten mjete të Komunës në rast se nuk ka dëme, nëse ka ju shpërndani bujqve mjetet buxhetore sipas vlerësimeve, kurse të na tregoni përralla këtu në foltore se çfarë mendoni ju, nuk bëhen ato punë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së jemi kundër miratimit të projektbuxhetit, për shumë arsye. Vërejtjet tona i kemi dhënë në seancën kur kemi shqyrtuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, dhe kryesorja ka qenë tek mos specifikimi i projekteve. Dua të ndërlihem me diskutimin e parafolesit z.Ragip Fetahu të cilit edhe i bëjë pyetje tani, nëse ty të pyet ndokush, ndonjë qytetar për fshatin e juaj se cila rrugë do të asfaltohet në fshatin e juaj, t'i sigurisht se nuk do të dini t'i tregoni.

Pastaj problem tjetër është edhe diskriminimi i shumë vendbanimeve që janë bërë për investimeve kapitale, mos dhënia e prioritetit nga kjo qeverisje në fushat e shëndetësisë, arsimit dhe bujqësisë ku vazhdimisht gjatë qeverisjes së kaluar ne së bashku me LVV-në si opozitarë i kemi kritikuar, kurse tani me këtë projekt buxhet rreth 70% e mjeteve shkojnë për infrastrukturë dhe urbanizëm. Pra propozim buxheti për vitin 2022 i sjellë nga LVV për miratim në Kuvend, ma kujton buxhetin e vitit 2021 kur LDK e ka sjellë për miratim dhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së edhe atëherë kemi qenë kundër. Ndërsa sa i përket pasojave nga mos miratimi i buxhetit, përgjegjësia mbetet tek qeverisa aktuale.

znj.Mimoza Stublla – Abdullahu, theksoi, është thënë shumë herë dhe është premtuar se do të ketë ndërtim të Çerdheve në Komunën tonë, ndërsa në këtë projektbuxhet nuk është paraparë as edhe një vetme të ndërtohet, madje edhe tani në fushatë po thuhet se do të ketë ndërtim të Çerdheve dhe është ndarë buxhet, jo nuk është ndarë buxhet për një gjë të tillë përderisa nuk figuron askund në propozim buxhetin për vitin 2022 dhe projektet prioritare për vitet 2023/2024, e kuptojmë se është fushatë ama ju lutem mos luani me brezin më të ndjeshëm të vendit tonë dhe me gjithë qytetarët e tjerë. E them këtë se përderisa nuk është paraparë një gjë e tillë në projekt buxhet, përse po dilni në fushatë dhe po

thoni se janë paraparë mjetet buxhetore dhe do të ndërtohen Çerdhet e reja në qytetin tonë. Është fakt se ka filluar renovimi i një Çerdheje në Qytet, por ato mjete buxhetore janë ndarë nga ky Kuvend dhe janë për këtë vit, por jo për vitet e ardhshme.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, shqetësimet dhe vërejtjet rreth këtij projektbuxheti po thujse u potencuan nga parafolësit, dhe tani unë kam vetëm disa pyetje për Ekzekutivin e Komunës, dhe atë, sa i përket shkollës së fshatit Obrançë e ceku edhe kolegu z.Rafet Llapashtica, por kemi edhe largimin shkollës së fshatit Dumosh e cila ishte e paraparë të ndërtohet në vitin 2022 dhe është zëvendësuar me ndërtimin e shkollës në fshatin Lluga e që normal kjo është një favorizim i kryetarit për fshatin e tij.

Nuk dua t'iu mbetem borxh edhe bashkëfshatarëve të fshatit Lladoc prej nga vije unë, pasi për vitin 2021 ishte e paraparë edhe faza e parë e ndriçimit gjë që as që ka filluar ende, kurse për vitin 2022 ishte e paraparë edhe faza e dytë e ndriçimit publik e që është larguar, pastaj kanë qenë të ndara edhe një shumë e mjeteve buxhetore nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit por që edhe ato janë larguar me këtë projektbuxhet, do të thotë deri në vitin 2024 as edhe 1 euro nuk është ndarë për fshatin Lladoc.

Sa i përket bujqësisë e kam vërejtur se është larguar fondi për subvencionimin e bujqve të cilët dëmtohen nga fatkeqësitë natyrore, normal se nuk ishte një shumë buxhetore e kënaqshme që ishin ndarë vitin e kaluar 76,000.00€, kurse tani nuk është paraparë fare.

Kam dëgjuar edhe zotimin e kandidatit për Kryetar të Komunës i cili është edhe Kryetar aktual, për ndërtimin e stacionit të autobusëve, por që në këtë projektbuxhet nuk kam parë as edhe 1 euro të ndarë për atë projekt.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, sa i përket projektbuxhetit për vitin 2022 unë fillimisht kam disa kritika rreth ecurisë së punës për buxhetin e vitit të kaluar e që siç edhe jeni në dijeni fatkeqësisht Sekiraça është së bashku me fshatin Gllamnik dhe pas bashkëpunimit që kishim me LDK-në për herë të parë kemi përfshirë një buxhet në projektbuxhetin e vitit 2021 në kuadër të drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për Gllamnik – Sekiraçë e që ishte në shumë rreth 70,000.00€ me destinim për asfaltimin e të gjitha rrugëve të fshatit, andaj nuk e di përse ka qenë e nevojshme që ky kod buxhetor të bashkohet me kodin e fshatit Buricë me qëllime që të mbeten disa “mite” dhe të mbeten disa rrugë të paasfaltuara. Për vitin 2022 janë paraparë vetëm 30,000.00€ dhe atë për asfaltimin e rrugëve në fshatin Gllamnik dhe nuk jemi në dijeni se a do të përfundohen të gjitha projektet të cilat kanë mbetur në gjysmë.

Sa për informacionin e juaj unë do të votoj kundër këtij projektbuxheti duke pasë parasysh edhe të gjitha ato kritika që i potencuan parafolësit.

Sa i përket projektit që e ceku kolegu z.Rafet Llapashtica që sot është proceduar për rend të ditës nga Kryetari, vlen të theksohet sa për transparencë se ne shefat e Grupeve të subjekteve politike sot në mëngjes ishim në takim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, dhe projekti i cili është nga Fondacioni i Elvis Naçi, është projekt shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm për Komunën e Podujevës, shifra e atij projekti ndoshta mbërrin mbi 1 milion euro, mirëpo lokacioni që na u propozua është i papërshtatshëm dhe qysh nga dita e djeshme ne kemi qenë në kontakt me banorët e atij lokaliteti të cilët as që janë të informuar se çfarë do të ndërtohet saktësisht aty, mirëpo janë kundër ndërtimit të një lagjeje në atë lokalitet, dhe mirë që sot nuk erdhi në rend të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, i dëgjova të gjitha kërkesat, vërejtjet, propozimet duke filluar nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave deri tek kolegët anëtar të këtij Kuvendi dhe ajo që unë dëshiroj ta them fillimisht është se kjo seancë është e vonuar ngase është dashtë të thirret shumë më herët dhe përgjegjësinë për këtë vonim të seancës fillimisht e bartë Kryesuesi i Kuvendit bashkë me Ekzekutivin e Komunës, e them këtë duke marrë për bazë edhe faktin se diku nga 20 gusht 2021

kanë filluar të mbajnë seanca Kuvendet e Komunave tjera. Kjo vonesë shkakton tani ndoshta edhe mos miratim të buxhetit për arsye se jemi vetëm 3 ditë para 30 shtatorit si datë kjo e përcaktuar përfundimtare për miratimin dhe dërgimin e projektbuxhetit të komunës, prandaj në këtë drejtim është dashtë ta kenë për bazë të gjithë akterët/ekzekutivi dhe gjithë të tjerët që kanë pozita në Komunën tonë.

Jam kundër koncentrimit të projekteve, kam qenë, jam dhe do të jem deri në fund dhe për asnjë çmim nuk e përkrahi koncentrimin e projekteve në një rajon apo në rajonin tjetër nga cilët vijnë persona të ndryshëm, dhe vërejtje të tillë i kam dhënë LDK-së në të kaluarën dhe të njëjtën po e përsërisë edhe sot si dhe do ta përsërisë çdo herë për arsye se buxheti i Komunës nuk është vetëm i një rrethi por është kontribut i gjithë qytetarëve të fshatrave, lagjeve dhe banorëve pa dallime politike dhe dallime tjera andaj në këtë drejtim kam vërejtjet e mia edhe për këtë propozim projektbuxhet për të cilin jemi duke diskutuar.

Nëse hyjmë dhe analizojmë në detaje këtë projektbuxhet atëherë është një vërejtje edhe tek investimet e bëra, shembull, mungojnë investimet në vitet 2022 dhe 2023 pikërisht në fshatin prej nga vije unë, pra asnjë cent nuk është paraparë të investohet në fshatin Shajkoc. Kam dhënë propozim të hapur dh zzyrtar para të gjithëve se për 20 vite ish pushteti i LDK-së nuk ka investuar në shtëpinë e Dëshmorit dhe Heroit Hasan Ramadani, dhe kjo është për keqardhje dhe për kritikë të madhe, kam dhënë propozimin që në atë shtëpi të ketë investime edhe nga Ekzekutivi aktual që është. Përse nuk ka investime në këto vende, edhe këta qytetarë japin kontribut dhe i kryejnë tatimet dhe obligimet qytetare, ndërsa në vitet 2022 dhe 2023 asnjë cent nuk parashihet për fshatin Shajkoc, pastaj në fshatin Gllamnik janë paraparë vetëm 30,000.00€, ndërsa ka qenë kërkesë e kamotshme edhe për LDK-në por edhe tani për juve kolegë të LVV-së për ndërtimin e një ure dhe një rruge në lagjen “Lala” dhe tani fare nuk është përfshirë në këtë projektbuxhet.

Sa i përket mos specifikimeve të projekteve, u japin kritika nga LDK-ja e për të cilën unë them se është kampion për një gjë të tillë dhe nuk e di përse sot mund të japin vërejtje të tilla, mirëpo edhe unë si anëtar i këtij Kuvendi nuk e përkrahi këtë mos specifikim të projekteve nga ana e Ekzekutivit të Komunës sepse duhet të specifikohen, shembull, tek drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit parashihen mjete buxhetore në shumë 150,000.00€ për ndërtimin e terreneve sportive, por vetëm kërkohet të specifikohen ku do të ndërtohen dhe besoj se krejt në rregull do të ishte ngase secili prej neve besoj se është në dijeni se për 1 vit nuk mund të ndërtoj terrene sportive në gjithë Llapin, e që për një projekt të tillë është kërkesë e kamotshme e banorëve të fshatit Shajkoc e që pa dashur të hyjë shumë në politikë e them se në tri palë zgjedhjet e fundit LVV ka dalë e para në fshatin Shajkoc, dhe tani kur shkojnë 2 vite dhe nuk parashihen asnjë cent investime në këtë fshat, mendoj se nuk është mirë dhe nuk është seriozitet kjo, prandaj në këtë drejtim duhet pasur kujdes të gjithë. E kam thënë në fillim se unë i jap disa betime politike, por në jetë vetëm një betim e kam dhënë dhe do ta mbrojë deri në fund, dhe ai betim është drejtësia, parimi, respektimi i ligjeve dhe rregulloreve pavarësisht cili subjekt, person apo individ është në pyetje, ky do të jetë vizion i imi, ka qenë dhe do të jetë edhe në të ardhmen, prandaj në këtë drejtim kërkoj se duhet të merren për bazë kërkesat edhe të opozitarëve dhe ato të qytetarëve në mënyrë që të mos vijmë deri te një gjendje të mos miratimit të projektbuxhetit të komunës nga ana e këtij Kuvendi.

Po të ishte mbajtur seanca më parë, jam i bindur se në bashkëpunim edhe me opozitën do ta trajtonim më ndryshe dhe ky projektbuxhet ndoshta do të miratohej.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për shkak të korrektësisë më duhet të përgjigjem në çështjen që e ngriti parafolësi rreth thirrjes së kësaj seance. Veç është e konfirmuar se e kam shpërndarë informatën për të gjithë Ekzekutivin e Komunës që sa më shpjet të jetë e mundur, kushdo që ka materiale t’i sjellë/procedoj në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit dhe të procedojmë me mbledhje duke

qenë në dijeni për rëndësinë e kësaj teme që na pret, pra nëse nuk gaboj kam kërkuar që deri më datën 07 të këtij muaji të sjellën materialet, pra kjo ishte vetëm sa për korrektësi.

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, sa i përket projektbuxhetit pajtohem me parafolësit e mi nga LDK-ja në fakt edhe me z.Rafet Llapashtica, mirëpo dola këtu jo për të bërë vërejtje por më tepër në aspektin profesional që më bënë të mos anashkaloj një çështje. Ne i dimë detyrat dhe përgjegjësit që kemi si asamblistë mirëpo edhe një detyrë dhe përgjegjësi e jona është që të jemi shembull për të gjithë.

Po i referohem fjalorit i cili u përdor paraprakisht, kolegu nga LVV kërkoi falje mirëpo pa dashur të mbajë ligjërata në aspektin profesional, kur ta përdorim një term duhet ta dimë mirë domethënien e atij termi, po e përsërisë se nuk dua të mbaj ligjërata se çka do të thotë termi idiotizëm dhe idiot, mirëpo dua të tregoj që më së pari shërben si fyerje e inteligjencës të secilit prej nesh që jemi këtu si dhe është një fyerje dhe një ofendim edhe për kategorinë e idiotëve, kështu që thjesht vetëm desha ta them këtë sepse nuk munda ta anashkaloj nga aspekti profesional.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit parafolëses për tërheqjen e vëmendjes, mirëpo konsideroj se u sqarua ajo çështje dhe tani është e kaluar.

znj.Elhame Kutllovci, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, theksoi, desha ta bëjë një replikë me asamblistin z.Rafet Llapashtica i cili e përmendi Bibliotekën e qytetit dhe njëkohësisht të bëjë një korrigjim të vogël për shkak se investim kapital nga qeverisja më herët kanë qenë të parapara jo 10,000.00€ por 50,000.00€. DKRS-së është marr shumë me Bibliotekën dhe nuk e di sa jeni të informuar ju asamblistë të nderuar por për këtë gjë më mirë mund t'i pyesni studentët tanë. Me ardhjen e qeverisjes sonë e kemi zgjatur orarin për studentë i cili askund në botë nuk funksionon që Biblioteka të mbyllet në orën 16:00, do të thotë ka punuar deri në ora 16:00 duke e ndërlidhur këtë me orarin e punës së administratës që bashkë me studentë të shkojnë në shtëpi, por ne e kemi zgjatur orarin për Bibliotekën ku salla e leximit është e hapur deri në ora 23:00, kuptohet në kushte normale për shkak se tani jemi në kushtet e Covid-19, kjo zgjatje e orarit ka bërë që në Bibliotekën e qytetit të ketë një frekuentim më të madh të lexuesve Llapjan gjë që është në të mirë të të gjithëve duke llogaritur që kanë qenë deri në 3-4 lexues brenda ditës kurse tashmë janë rreth 40 nxënës dhe student brenda ditës në sallën e leximit. Përveç kësaj renovimi nuk ka qenë i cekur se ku duhet të bëhet me ato 50,000.00€ dhe ne nuk mund të ndërtojmë një Bibliotekë të re me atë shumë, por kemi ndërtuar një infrastrukturë më të mirë duke bërë rinovimin e Bibliotekës e cila shumë shpejtë do të jetë e hapur për lexuesit tanë, pra renovimi i Bibliotekës është duke ndodhur në pjesën tjetër të objektit të Komunës së vjetër në ish sallën e asamblesë komunale.

Sa i përket çështjes tjetër që e ceku kolegu z.Ragip Fetahu që Podujeva ka shumë nevojë për infrastrukturë kulturore, sportive dhe rinore, mund të themi se nuk është faji ynë që për 20 vite nuk është bërë asnjë investim, ju them me sinjeritetin më të madh se prej marrjes së detyrës si drejtoresh e DKRS-së kërkesat më të mëdha nga ky sektor kanë qenë në infrastrukturë dhe tani të kërkohet se cilat janë vendet dhe lokacionet që do të bëhen ato rinovime më duket paksa banale përderisa është dashur në njëfarë forme që ju ta mirëprisni këtë investim që pas 20 viteve po ndodh në Komunën e Podujevës. Meqë sot veç jemi në sallën e Teatrit “Avdush Hasani” e di që shumica prej juve nuk jeni vizitor të Teatrit por ju kisha sugjeruar që sot pasi që jeni këtu të shkoni dhe t'i vizitoni tualetet e Teatrit të cilat për 20 vite kundërmojnë nga era e keqe që është këtu brenda, mirëpo me ardhjen tonë në qeverisje kemi bërë një investim të vogël dhe procedura është në prokurim e që do të rregullohen tualetet dhe huaje-ja / holli i Teatrit dhe të mos flasim për gjëra tjera që Podujeva ka shumë nevojë për investim, dhe kur flisni për kulturë ndoshta është mirë me u adresu sepse për herë të parë e keni njeriun e kulturës përball.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot aktualisht jemi duke e diskutuar temën e propozim projektbuxhetit edhe pse secili prej nesh e dinë që kjo është çështje e Ekzekutivit, po flas në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, do të thotë nuk është marrë asnjë iniciativë dhe asnjë kërkesë që së bashku me ne si Grupi më i madh që jemi në Kuvend ta trajtojmë kërkesën dhe nevojat e qytetarëve.

Pa dashur të ulem në fjalorin e asnjë asamblisti që diskutuan më parë, kërkesat dhe nevojat secili prej nesh i dimë se cilat janë dhe mendoj se duhet të lirohemi paksa prej ngarkesës politike dhe kjo ka rëndësi sepse e di që është fushatë zgjedhore dhe secili prej jush pretendon që ta shfrytëzoj këtë, mirëpo gjithmonë duhet të jetë në harmoni dhe në pajtim edhe me mundësit reale që janë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, fillimisht e them se ne duhet të mësohemi dhe të kërkojmë falje dhe në këtë aspekt unë kërkoj falje për fjalën e përdorur më parë por mbi të gjitha qytetarëve sepse nuk është në natyrën time të përdori fjalë fyese dhe ofenduese, mirëpo fjala të cilën e përdora është si rezultat i frustrimit të përgjithshëm për mentalitetin politik të instaluar që kemi pasur që 20 vite këtu, dhe asgjë më shumë, prandaj të mos merret kjo si fyerje apo ofendim por është thjesht edhe si koncept shkencor që mund të quhet një rrymë e tillë politike.

Sa i përket pyetjes së z.Rafet Llapashticës, ne e kemi në informatën e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të cilën besoj që të gjithë e kemi para vetës, vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe breshëri është rreth 400,000.00€, aty ceket shumë qartë dhe është proceduar në Ministrinë e linjës konform rregullave dhe parimeve të Ministrisë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, desha të ndalem tek DKRS dhe tek procedimi i mjeteve për bujqësi, ngase qytetarëve nuk i'u interesojnë procedurat por mjetet financiare, Komuna ka obligim moral dhe ligjor si dhe ka hapësirë ligjore dhe morale të ndaj mjete për bujqit, normale që edhe dikasteri qendror i ka linjat e tij të subvencionimit, por Komuna e Podujevës nuk ka paraparë asnjë cent për këtë çështje, kanë qenë rreth 80,000.00€ më parë, mirëpo tani shumë keq sepse ju po ankoheni se ka qenë keq, por sadopak kanë qenë të parapara mbi 80,000.00€ dhe dikush ka përfituar nga ndarja e tyre me shumica të caktuara, dikush për dëmin e një sere ka marrë 200€ apo më shumë, mirëpo tani janë hequr edhe ato mjete buxhetore që kanë qenë, pra këtu është problemi.

Tek DKRS, nuk po dua të ngrisë debat të gjatë por po dua sqarim sepse ndoshta dikush brenda Kuvendit kur bisedohet diçka para 1 ose 2 viteve edhe harrohet çfarë është diskutuar e që unë nuk harroj, përgjegjësinë për ndërtimin e Bibliotekës e ka marrë z.Shpejtim Bulliqi i cili ka thënë do ta ndërtoj po sa të vije në qeverisje, pra nuk ka thënë që do ta rinovoj atë që është në objektin e vjetër të Komunës (objekt i cili është prej kohës së Titos), pra ka thënë e ndërtoj Bibliotekën sepse këtu qytetarët kanë mbetur pa Bibliotekë dhe tani unë po flasë duke u bazuar në këtë sepse vetëm kafshët lidhen për litari kurse njeriu lidhet për fjale në jetë civile kurse për ligji kur është në institucion.

Për një vit e gjysmë e arsyetoj që nuk ka mundur sepse e ka gjet buxhetin si e ka gjetur ashtu siç po ankohen tani nga LDK për këtë propozim buxhet në mënyrë që të mos ketë ankesa të serishme për 4 vite nga Kryetari i ardhshëm, kushdo çoftë ai, por edhe nëse bëhet z.Shpejtim Bulliqi nuk e ka në plan as në vitin 2022 të ndërtoj Bibliotekë por e ka në plan vetëm ta gëlqerosë me ngjyra aty – këtu, prandaj kjo është problem për mua si qytetar sepse unë e kam përfunduar shkollimin dhe nuk shkoj aty të përgatitem për provime, por ndokush (nxënësit dhe studentët) kanë për të shkuar. Do të thotë ky është plani për këtë nëse fiton sërish ky Kryetar dhe këtë qytetari duhet ta dijë që nuk është planifikuar fare në këtë projektbuxhet nëse veç miratohet.

Çështja tjetër është ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës, që 8 vite jam anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, dhe për gjitha këto vite me rend LDK e ka sjell këtë shumë buxhetore për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës dhe ende nuk e kemi Shtëpinë e Kulturës funksionale në Podujevë, tani për t'i ndarë këto mjete dhe për tu paraparë është dashtë për të më bindur edhe mua sot është dashur të vije propozimi nga ju dhe të na thoni me propozim konkret në teren dhe me miratimin e Kryetarit duke

përfshirë edhe dokumentacionin e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë lokaliteti se ku është ndarë për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës dhe ta prezantoni për Podujevën se janë paraparë 100,000€ për vitin 2022 dhe puna do të filloj në këtë muaj.

Shumë pak jam i interesuar me të vendos letër tani, unë nuk kthehem mbrapa se çfarë ka bërë LDK sepse po diskutohet çka ka bërë në të kaluarën..., *(nga këshilltarë/e – prej vendit kërkohet që të respektohet minutazhi nga ana e zotëri Llapashtica mirëpo ky i fundit potencoj se montazhin e diskutimit nuk e cakton Kuvendi sepse jemi në seancë dhe me orar nuk e kemi, përndryshe e nderuar këshilltare në çiftë se ke ndonjë obligim tjetër dytësor ti mund të vazhdosh, nuk ka rregulla në Kuvend që e përcakton kohen se sa do të zgjas një seancë e Kuvendit, e them këtë ngase po e vërej që jeni në siklet të madh të dilni nga kjo seancë por ne kemi me marr vendime këtu)* vazhdoi.... por unë dua ta di a ka për tu ndërtuar Biblioteka apo jo, e që mendimi im është jo sepse nuk ka mjete buxhetore të parapara as nga ju as nga Kryetari z.Shpejtim Bulliqi edhe nëse e fiton për 4 vitet e ardhshme, pra nuk e ka paraparë të ndërtohet një Bibliotekë në Podujevë, një Shtëpi e Kulturës dhe kur flasim për kulturën, pyes a të bënë përshtypje ty si drejtoresh e DKRS-së Teatri kur ti hyn këtu, ku janë duke punuar tani skulptorët për momentin që i pash aty në hollë sikurse të ishte “një kotec i pulave”, është turp kjo dhe ai që i thotë vetes zotëri, “pulën nuk e lënë aty të punoj” e jo njeriun/artistin. Do të thotë nuk është kultura vetëm diçka që mendojmë ne çka mund të bëjmë me mundësinë tona por kultura është kur ka Teatër ku mbahen shfaqje, kur ka ambient për punë skulptori, kur ka Bibliotekë nxënësi dhe studenti, pastaj ku është Shtëpia e Kulturës, përndryshe “urrallarë”.

Nëse sërish pranon qytetari të jetë kështu i fundit jam unë që mërzitem për këtë punë, mund ta vazhdoni por ne të themi po dhe të bëhemi barrë për ta miratuar këtë buxhet, kështu jo, me votën time jo, ose duhet si z.Ragip Fetahu të kërkoj falje edhe Kryetari i Komunës për gënjeshttrat e tij dhe të thotë (“i kam gënjer mësuesit sepse e kam punësuar atë “Rударin dhe Naimin” dhe nuk kam mundur sepse edhe ai ka qenë opozitar sikurse tani që jemi dhe kam thënë se do ta zbatoj kontratën kolektive kurse tani nuk po dua të ua jap ato mjete sepse jam ulur në karrige dhe nuk ju jap, mandej i kam premtuar studentit Bibliotekën po nuk po e ndërtoj dhe çka po doni, unë po i dua votat, ti çfarë po don), kështu duhet të themi ne para LVV-së, shkoni ne i ngritim duart dhe vendoseni në proces që të ecë tutje buxheti, por duhet të dalësh këtu dhe të thuash jo, madje çka ndoshta është kundër edhe këshilltari/kandidati juaj aty ulur z.Haki Rudari, prandaj debati me Kryetar të Komunës ndryshe bëhet por jo kështu në këtë formë. Pra nuk e mora fjalën për ty si drejtoresh e DKRS-së sepse e di që faji më i vogël është tek ti, madje ndoshta ti do i kishe bërë këto.

znj.Elhame Kutlovci, drejtoresh e DKRS, theksoi, e para i nderuar z.Rafet Llapashtica, Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi nuk gënjen dhe të kisha sugjeruar që bashkë me mua pas seance të shkojmë në objektin e vjetër të Komunës dhe ta shohësh Bibliotekën e cila po bëhet, muret nuk i kemi ndërtuar, renovim nuk kemi lyer me ngjyrë dhe aty mund të them se ka qenë një katrahurë që është shumë i vjetër si objekt për çka të gjithë e dimë se si ka qenë objekti. Biblioteka ka për tu bërë me të gjitha gjërat e nevojshme për lexuesit aty ku është salla e Kuvendit Komunal, komplet me inventar me ndërtim të ri dhe me internet, e që është lënë pa internet nga qeverisja e mëhershme, edhe pse keni qenë në dijeni se kanë qenë masat e qeverisë anti covid-19, studimet zakonisht janë bërë në mënyrë online dhe studentët nuk kanë pasur internet për t’i zhvilluar ligjëratat e tyre por që ka munguar një vullnet i vogël për t’i pajisur me internet, ndoshta ka munguar një vullnet i vogël që me 50 € të rregullohet ndriçimin që nuk e kanë pasur, pastaj 50 € kanë kushtuar ato drita tani që janë vendosur në Bibliotekën e vjetër ku mësojnë studentët ashtu siç ka munguar një vullnet i vogël për ta rregulluar ngrohjen e cila nuk ka funksionuar, e ne këto ua kemi, përse, sepse z.Shpejtim Bulliqi nuk gënjen. Prandaj e them se ka munguar vetëm vullneti për të punuar për qytetarët.

Tek Shtëpia e Kulturës, ne nuk e kemi ndërmend si LDK-ja me të ndajmë parcela dhe mandej ato dalin konteste pronësore siç ishte rasti me palestrën sportive për të cilën si shkak i pronave është

humbë investimi, pra është humbur dhe nuk është askund sepse është ndarë parcelë ku aty ka probleme pronësore, mirëpo e kemi në plan për vitin 2022 ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës, konkretisht është në planet e Ministrisë së kulturës rinisë dhe Sportit dhe këtë ua garantoj unë, ua garanton Kryetari z.Shpejtim Bulliqi dhe ua garanton qeverisja e z.Albin Kurtit.

Çështja tjetër, e potencova edhe më herët se për investime në infrastrukturë ka shumë nevojë, pastaj u fol për këtë Teatër dhe këtu askush më mirë se unë nuk e njeh Teatrin, unë e kam punuar në këtë Teatër këtu dhe më besoni se kur kam punuar për 2 muaj nuk kam pasur ku të hyjë në tualet gjë për të cilën e ceka edhe më herët se nuk është në rregull kjo që kanë bërë këtu, kanë rregulluar skenën, kanë rregulluar karriget por qysh është gjendja jashtë Teatrit. Nga parafolësi u cek edhe për skulpturë e që mendoj se ka të drejtë sepse skulptorët nuk e kanë një shtëpi ku do të mund t'i paraqitnin mjetet e tyre artistike por z.Shpejtim Bulliqi po ua bënë tani atë, pra nëse flasim politikisht zotëri Bulliqi po ua bënë ish objektin e “Benidonës” dhe z.Shpejtim Bulliqi është duke e shndërruar në galeri të arteve për qytetarët Llapjan, do të filloj këtë vit dhe do të jetë projekt 2 vjeçar, do ta bëjmë edhe muze ngase është marre kur vijnë vizitorët në Komunën e Podujevës dhe nuk e ke as një gjë të kulturës t’ju tregosh atyre përveç asfaltit e që e them se mjaft më jemi lodhur me asfalt. Prandaj do të ketë investime edhe në kulturë dhe tani e tutje ka për të pasur vend për të gjithë artistët në Podujevë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e nderuar drejtoresh e DKRS-së po të them seriozisht se z.Shpejtim Bulliqin e njoh më gjatë se ju sepse i takoj gjeneratës pak më të vjetër dhe unë nuk po të sugjeroj tani të bësh çfarë të them unë sepse nuk insistoj për një gjë të tillë. Unë i kuptoj edhe politikanët e partive politike dhe kur e them këtë mund të mendosh në aspektin subjektiv të LVV-së në këtë rast, por unë e them për të gjitha partitë politike “kur qesin shkelma” kur nuk ju pëlqen diçka por unë nuk nxehem/ngutem ashtu shpejt, unë ashtu siç nxehem ashtu ngadalë edhe ftohëm ngadalë.

Ju po potenconi se nuk gënjen z.Shpejtim Bulliqi, dëgjo drejtoresh, nuk po dëshiroj ta përmend shumë mirëpo në atë objektin ku po thua ti se nuk kam mundur të rri prej aromës së tualetit, z.Shpejtim Bulliqi ka qenë drejtor ashtu siç ke qenë pjesë e Teatrit të Podujevës ti këtu, dhe tani ti duhet ta demantosh deklaratën tënde kur përmenden emra këtu të atyre që kanë qenë pjesë e Ekzekutivit dhe sektorëve tjerë, pastaj askush këtu nuk bënë asgjë me para të gjepave të tij por me para të vendit (shtetit). Nëse Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqit i kërkon ti drejtoresh 50€ për këtë derën e cila ishte e lidhur me litar (sixhim) dhe nëse ju jap ai ato mjete nga gjepi i tij personal për ta rregulluar dorezën e derës atëherë jemi në rregull. Mandej atë zyrën që e potencuat se shëtitin minjtë, është edhe sa ka qenë z.Shpejtim Bulliqi drejtor i DKA-së, prandaj tani të mos hyjmë në aspekte të tilla politike, por as ju vet dhe rrethi yt drejtoresh për LDK-në as një fjalë nuk e keni thënë, ndoshta jo që nuk do ta thojë por ke qenë e rrethuar për të mos e thënë, ndërsa unë e kam thënë dhe e them sërish e këtë mund ta shohësh nëse kthehesh në retroaktivë ngadalë dhe vetëm mendon dhe kujton se çfarë ke thënë ti dhe rrethi yt për z.Agim Veliun që thosht “sadami i Podujevës i cili vetëm pallton e lënë këtu”, prandaj tani unë nuk mund të votoj ty vetëm pse po thua z.Shpejtim Bulliqi i Podujevës. Shumë pak jam i interesuar të dëgjoj njerëz dhe rrethe familjare që e kanë veshur pallton e z.Agim Veliut për 20 vite dhe janë kthyer e veshin pallton e z.Shpejtim Bulliqit tani, me mua si Rafet ashtu nuk mund të bisedosh.

Çështja tjetër, për Shtëpinë e Kulturës po e them sërish gënjen dhe e ripërsërisë gënjen ngase ka thënë do ta ndërtoj e jo do ta rinovoj, por nëse ti drejtoresh që po thua jam artiste dhe kam kryer shkollë nuk e kupton dallimin e renovimit me ndërtim është diçka tjetër, (diçka tjetër është me i rregullu apo me vendos disa gjëra në këtë sallë dhe diçka tjetër është me rrëzu këtë objekt dhe me ndërtu një objekt të ri të Teatrit ose Bibliotekës). E them këtë sepse qysh ka qenë e dimë të gjithë por nuk mund të kthehem unë retroaktiv dhe të mendoj se çfarë ka për të bërë z.Shpejtim Bulliqi

ngase e di shumë mirë se e ka interesin aty sepse nuk ka folur dhe zëri nuk ju ka dëgjuar ngase në atë Komunën e vjetër ku i ke vendosur nxënësit ti drejtoresh, kryetari në të kaluarën ka qëndruar në vijë sa e ka pasur interesin por siç ju ka prishur interesi nuk ka qëndruar më, të njëjtën edhe këtyre ua bënë qysh ua ka bërë LDK-së dhe mos mendo ti që dinjitetit i njeriut ndërron për dy muaj, njeriu nuk ndërron me gjeneratë, kështu që unë e pranoj listimin politik apo akuzën kur është me vend qoftë edhe për subjektin tim që i takoj sepse nuk mund ta arsyetosh pastaj dhe nuk ke çfarë thua, përndryshe me lëvdime nuk shkon, por ai (kryetari) të vije këtu dhe të ballafaqohet me mua, jo me ata me të cilët bisedon siç ka dëshirë ai vet, por nëse e ballafaqon me dikë ashtu siç ka qejf ai atëherë ne i duartrokasim (sikurse i kanë bërë në të kaluarën Titos), kurse ju qëndroni ashtu siç jeni dhe vazhdo të mendosh që ai (kryetari) mund të bëjë mrekulli, mirëpo as ti si drejtoresh e DKRS-së nuk do të mund ta bësh atë që po thua sepse nuk bëhet puna kështu, dhe për këto gjëra unë duhet të të drejtohem ty drejtoresh edhe pse më së paku me ty jam i interesuar të ngrij debate, por meqë po e përmend disa herë z.Shpejtim Bulliqin, po detyrohem të të them ty dhe të tregoj unë se nuk është fare ashtu siç po thua ti.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e dëgjuam me vëmendje drejtoreshën e DKRS-së, ne jo që nuk jemi të kësaj fushe por për të kaluarën pyes atë a është e vërtetë që ke qenë anëtare e bordit të Teatrit në kohën e LDK-së.

znj.Elhamë Kutllavci, drejtoresh e DKRS, theksoi, tani u shtrua pyetja nga parafolësi kinse më kanë bërë “çirak” që kam ardhur këtu dhe më sjellë LDK-ja, e para e punës është se artistët nuk janë politik, dhe fusha artistike nuk mbrohet me politikë i nderuar z.Hasan Ajeti, kur më ka ftuar drejtori në fjalë z.Agron Gërguri ka qenë për të jap kontribut dhe a e dinë përse, sepse shumica e artistëve Llapjan kanë ikur, nuk kanë qenë të interesuar të bëjnë diçka për kulturë sepse ish Kryetari yt ua ka përplas derën në fytyrë dhe për këtë ju tregoj rastin konkret, për ti kryer studimet në regji të Teatrit në Fakultetin e Arteve, për një provim të regjisë shkojnë afro 3000€ deri në 4000€, shumica e studentëve të fakulteteve të arteve kërkojnë mbështetje nëpër komunat e tyre, Fakulteti i Arteve njihet me student të paktë për shkak se pak artistë mund të hyjnë në atë vend dhe unë kam qenë prej tyre që kam ardhur dhe i kam trokitur rastit konkret z.Agim Veliut, (si studente po flas jo si politikane apo si fanse e LDK-së) kam kërkuar mbështetjen e Komunës dhe ka qenë z.Agim Veliu që ma ka përplasur derën, po flas për një rast, por ku po dua të dal është se ka shumë artistë Podujeva mirëpo shumica prej tyre nuk janë në Podujevë për shkak se nuk kanë pasur hapësirë për të vepruar, nuk kanë pasur mjete për të mbijetuar dhe njëra prej tyre kam qenë edhe unë që nuk më ka ndal një përplasje e dres së z.Agim Veliut por kam ecë dhe kam vazhduar dhe atëherë kur Podujeva ka pasur nevojë siç ka tani nevojë, qeverisja e z.Shpejtim Bulliqit për njerëz profesional me qeverisjen e tyre, unë kam me qenë aty që të jap kontributin tim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, faleminderit për përgjigjen drejtoresh e DKRS-së, unë vetëm e bëra një pyetje për ju si ish anëtare e bordit të Teatrit, ndërsa për atë se sa je e suksesshme ajo dihet, por në atë që e ceke duke u lëshuar në historikun dhe duke përmendur ish Kryetari është temë tjetër sepse unë e di që përveç që ke pasur mbështetje në art ke pasur mbështetje edhe në bujqësi, do të thotë këto janë fakte të pa rrëzuara, t’i mund të flasësh për sot dhe për nesër se qysh e parasheh zhvillimin dhe rritje e infrastrukturës për Teatrin. E kam shpesh dhe po e përsërisë, për që ka qenë keq e ke fituar 50%, por besoj që tani nuk do të jetë ashtu dhe nuk do të fitosh. Dua të them se për të kaluarën duhet të kesh pak një kujdese të shtuar, unë të respektoj si figurë, si emër dhe si autoritet, mirëpo duhet të jeni transparent dhe objektiv në atë që të pyeta, në çoftë se flet për dje që ka qenë keq me trego sot dhe nesër qysh është mirë sepse fundja janë qytetarët ata që vendosin.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, pavarësisht që jemi në fushatë zgjedhore ju bëjë thirrje që debatin e sodit mos ta degradoni në sulme personale. Jemi në këtë mbledhje që të diskutojmë për projektbuxhetin, andaj ju lus që propozim projektbuxhetin ta diskutojmë deri në fund, por jo të lëshohemi në çështje personale ngase çështjet personale janë çështje të cilat mund t'i zgjidhni pas seancës, mirëpo jo në këtë seancë të rëndësishme ku diskutimi kryesor do duhej të ishte projektbuxheti.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, theksoi, dua t'i bëjë disa sqarime, fillimisht sa i përket kontratës kolektive për disa që parashtruan këtë çështje, kontrata kolektive ka filluar së zbatuari me orët që iu takojnë fillimisht mësimdhënësve që janë nga 2 orë për ata që janë nëpër sindikatë, pastaj është e vërtetë që Kryetari aktual i Komunës e ka gjetur një buxhet të planifikuar dhe nuk ka pasur mundësi ta realizoj atë që e ka thënë në atë periudhë kohore, mirëpo për njohurin e juaj në tabelat e buxhetit, në faqe 8 e keni të ndarë buxhetin për çështjen e zbatimit të kontratës kolektive.

U potencua nga z.Rafet Llapashtica edhe për mua çështja e buxhetit dhe u përmend emri im, por unë edhe sa isha shef i Grupit në kuadër të LDK-së nuk e kam votuar buxhetin i nderuar zotëri Llapashtica gjë të cilën ju kam rikujtuar ta rikujtoj sërish sa herë që është nevoja, por tani me gjasë nuk do të ketë nevojë sepse paraqitet e tua spektakulare veç se përfundojnë ndoshta me këtë seancë, përndryshe vitin e kaluar unë kam qenë në LVV dhe nuk e kam votuar këtë buxhet që po më atakon shumë herë. Pastaj monitorët janë funksionalizuar në muajin gusht dhe është mirë që janë bërë sepse nuk janë ata televizorë për të shikuar filma vizatimor siç po i përshkruan ti, por janë TV monitor që mund të shfrytëzohen edhe në pandemi edhe pas pandemisë.

Sa i përket objektit të shkollës në fshati Obrançë, për gjithë ju që e potencuat ju sqaroj se ajo ka qenë e planifikuar për vitin që po hyjmë 2022, kështu që nuk ka qenë edhe bash e sinqertë edhe prej anës suaj, krejt çfarë kemi bërë është që e kemi shtyrë për një vit andaj nuk mund të thoni që shkollat “Ali Hadri” dhe “Musli Dumoshi” i kemi hequr nga planifikimet dh këtë e gjeni në këtë projektbuxhet ashtu siç e keni projektuar ju e kemi projektuar edhe ne, ndërsa sa i përket çështjes së shkollës në fshatin Llugë, jo pse është Kryetari aktual prej atij vendi, por ju e dini shumë mirë që bash për inate është mbet ashtu qysh është mbetur ajo shkollë, prandaj jo pse Kryetari është prej asaj ane por vërtetë është në gjendje shumë të keqe ajo shkollë dhe meqenëse Ministria përkatëse e ka ndarë një shumë të mjeteve buxhetore, kemi ndarë edhe ne një shumë të caktuar.

Sa i përket çështjes së çerdheve, nga niveli qendror na janë kërkuar parcela për 4 çerdhe dhe e kemi dërguar dokumentacionin përkatës, përveç asaj çerdheje që kemi ndarë buxhet prej nivelit komunal për rinovim, janë edhe 4 çerdhe që do të ndërtohen nga niveli qendror jo vetëm për Komunën e Podujevës por edhe për komunat tjera.

Kam edhe një çështje për të cilën dua ta sqaroj me leje të drejtorit të DSHPMSh për shkak që më ka interesuar edhe e ndriçimi. Në fshatin Sfeqël në lloton 5 është precizuar qartë që janë 1849 metër, një distancë tjetër është 3 mijë metër dhe distanca tjetër është 140 metër. Gjithashtu edhe për fshatin Lladofcë sepse më ka interesuar për shkak të çështjes së shkollës dhe sigurisë që është në të, edhe aty janë 2700 metër por janë në lloton 5, prandaj ndoshta është mirë që në faqen zyrtare të prokurimit ku janë publike dokumentet, të shihet qartë çështja e këtyre investimeve.

z.Avni Islami, theksoi, meqenëse kjo është seanca e fundit e këtij Kuvendi komunal deri pas zgjedhjeve dhe konstituimit të kuvendit të ri, dhe në këtë kontekst dola t'ju përshëndes dhe t'ju uroj punë të mbarë të gjitha subjekteve politike dhe uroj që të fitoj më i miri.

Sa i përket projektbuxhetit që po diskutohet, mendoj që u shterën të gjitha debatet dhe kërkoj që të hidhet në votim dhe në fund të shohim se si po rrjedh rezultati.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, falënderoi të gjithë për diskutimet e tyre, si do që të kemi ato diskutime vetëm po dua t'i jap disa sqarime në formë përmbledhëse edhe pse disa prej tyre i sqaroj parafolësi z.Avni Fetahu dhe të tjerë, por disa që i konsideroj të vlefshme dua ti paraqes. Nga ajo që u tha nga përfaqësuesi i LDK-së z.Mehmet Gashi kinse ka ulje të buxhetit për vitin 2022 në raport me 2021, ajo është e pavërtetë për arsye se nuk e di a ishte e qëllimshme apo si gabim teknik sepse ju i keni llogaritur edhe klauzolën investive e cila është në shumë 1,125,298€ dhe besoj që jeni të informuar se çfarë është kjo klauzola investive, është kredia për kolektorin e ujërave të zeza, e vërteta është që ky kolektor është kredi prej Austriakëve me 0%, mirëpo ky kolektor paguhet dyfish më shumë sesa synimi dhe ai kolektor, thënë të drejtën janë gypa që janë të varrosur, as kolektor nuk është, por investimi është mbi 5 milion euro e që në raport me çmimin e tregut është 2 deri në 3 milion euro dhe janë hyrë aty ku kanë hyrë edhe shumë projekte tjera për 20 vite, por fatmirësisht nuk shkojnë më, dhe ajo kredi me austriak nuk është vazhduar, edhe ne do të mund të vendosnim 3 klauzola investive sërish me austriakët dhe kanë ardhur ata për bisedime sepse atë punë e kanë, me ardh me gllabëru këtë buxhet të qytetarëve të Komunës së Podujevës, me i marr edhe 3 milion euro, por qeverisja e LVV-së ashtu siç është zotuar dhe ashtu siç vepron nuk e ka vazhduar këtë marrëveshje me ata bashkë hajnat e tjerë që kanë qenë.

Çështja tjetër, tek rritjet e investimeve në arsim e kam thënë dhe po e them sërish se ka rritje të buxhetit, dhe të thuhet se ka ulje është shumë e pakuptimit dhe unë nuk po e di ku e gjeni tani atë që e thonë se ka ulje përveç nëse nuk e merret buxheti total e që normalisht që pastaj buxheti i pagave nuk është sepse ka ndryshuar përafërsisht, ka mbetur ai i njëjti sepse është edhe numri i njëjtë i mësimdhënësve dhe rrjedhimisht nuk ndryshohen edhe pagat në nivelin lokal, mirëpo ka rritjen e subvencioneve në arsim ku nga 50,000.00€ sa ishin për bursa në vitin 2021, është rritë në 100,000.00€ pra është dyfishuar, mandej për mallra dhe shërbime buxheti është rritë për 1.63 herë ku nga 570,246.00€ rritet në 928,656 më shumë në arsim dhe kur kemi thënë afër 5 fishin e kemi pasur fjalën vetëm tek pozicioni buxhetor. Për infrastrukturë të shkollave buxheti ka qenë 97,582.00€ dhe tani është rritë në 444,318.00€ apo 4.58 herë më shumë për përmirësimin e infrastrukturës shkollore përkatësisht të rinovimit të institucioneve arsimore.

Normale që buxheti dhe çdo pozicion buxhetor përveç që miratohet në Kuvende Komunale në fund është Ministria e Financave e cila mund të mos e aprovoj ndonjë projekt të caktuar, gjithherë vije në pyetje plotësimi i dokumentacioneve tjera dhe se sa është ai projekt në përputhje me strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm të cilën e miraton Parlamenti i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, prandaj për çdo projekt duhet të jepet arsyeshmëri dhe normalisht që logjika e kësaj çështje është se kur t'i e ndërton një buxhet atë e bënë në raport me prioritetet e shtetit sepse ne Podujeva në këtë rast nuk është republikë në vete por është një Komunë e cila vepron në këtë Republikë.

Sa i përket ndërtimeve të shkollave dhe çerdheve, tek çerdhet i kemi premtuar edhe i premtojmë por e ceku edhe z.Avni Fetahu që janë edhe disa donacione, mirëpo ka për t'i ndërtuar edhe nivelin qendror andaj nuk kemi nevojë ne të ndëtojmë me buxhet komunal kur një gjë të tillë e bënë nivelin qendror, ndërsa tek shkolla e fshatit Dumosh e cila është paraparë në vitin 2023, mirëpo kam biseduar edhe me asamblistin i cili vije nga ai fshat dhe i'a kam sqaruar që ekziston premtimi i qeverisë që kjo çështje me qenë financim edhe nga niveli qendror, por sido që të jetë e kemi buxhetin për vitin 2023 ku në projeksione figuron, mirëpo gjasat janë reale që kjo të filloj në vitin 2022 nga niveli qendror.

U cek edhe Stacioni i Autobusëve si premtim elektorale i LVV-së, mirëpo nuk figuron që është i buxhetuar ky stacion sepse është paraparë me partneritet publiko-privat ku besoj që e dini logjikën e investimit të partneritetit publiko-privat e që nuk bëhet me buxhetin e komunës dhe kjo është

logjika përse investohet me partneritet publiko-privat në mënyrë që mos të shpenzohet buxheti i Komunës por investimin ta bëjë privati dhe normalisht një pjesë e investimit që janë i takojnë Komunës dhe në fund pas 10 - 15 viteve varësisht se si e nxjerr analiza e fizibilitetit kalon në pronësi të Komunës, e njëjta çështje është paraparë edhe për parkingun nëntokësor.

Pati edhe një kritikë që u cekë edhe sa i përket KAB dhe që ka të bëjë me specifikim të projekteve e që vetëm LDK-së dëshiroj t'ua rikujtoj sepse po harrohen disa gjëra, vitin e kaluar kur ka ardhur miratimi i buxhetit nga ana e ish administratës komunale, diku janë mallrat dhe shërbimet të gjitha që kanë qenë, vitin e kaluar kanë qenë 2,553,578.00€ total, ka qenë vetëm kështu si buxhet total dhe nuk ka pasë asnjë specifikacion se a është lëndë djegëse, as a është furnizim me ushqim, a është pajisje, a është inventar, mobilje, dhe ashtu keni votuar për 2,700,000.00€ si grumbull në kategorinë e mallrave. Pastaj u përmenden mobilet dhe çështjet e arsimit, mobilet apo inventari që do të blihet dhe fjala është për banka dhe karrige sipas pozicionit buxhetor përkatës të cilën e potencuam. Sa i përket çështjes së specifikimit tek projektet e caktuara, shembull ndërtimi i rrugëve në fshatin Llapashticë ose në fshatin Batllavë apo varësisht se ku janë këtë investime, tani e vërteta është që rrugët të cilat janë më të gjata janë të ndërtuara dhe pjesa dërmuese kanë mbetur disa rrugë më të vogla.

Në programin e investimeve publike, normal që ky si dokument është si standard i sjellë në atë formë ku janë disa tabela në Excel ose në Word të cilat kurdo mund t'i ndërtosh, mirëpo aty është njëri nga kriteret që faktikisht as në mënyrë teknike nuk ta lejon shtimi e më shumë se 50 karaktereve/shkronjave që është si maksimum për një projekt, dhe tani shembull ta marrim një fshat me 60,000€ të parapara mund të ndërtohen 30 rrugë/rrugica të vogla dhe teknikisht është e pamundur t'i përfshish në pozicion siç kemi rastin ta zëmë në shërbime publike ku do të bëhet rregullimi i ndoshta 100 rrugëve me zhavorr dhe është e pamundur të përfshihen në programin e investimeve publike. Tek pozicioni i rinovimeve të institucioneve arsimore me këtë vlerë financiare nga e cila pothuajse kanë për tu bërë ndërtime në çdo shkollë.

A jeni në dijeni se çfarë do të thotë specifikim i projekteve, për ta specifikuar një projekt do të duheshin 20 faqe emërtim të projekti, (ta zë renovimi i njeve sanitare në shkollën e fshatit Herticë, gëlqerosja e jashtme në shkollën e Herticës, mandej rinovimin e dyshemesë ta zëmë në shkollën e fshatit Dumnicë, rregullimi e dyerve në shkollën e fshatit Kërpimeh e të tjera), pra do duheshin 30 faqe specifikim të projektit, mirëpo vërtetë sot ka rastisur që mbledhjen e asamblesë komunale ta mbajmë në sallë të Teatrit, por nuk është mirë të bëjmë teatër mirëpo nëse është arsyeja pse nuk duhet të votohet ky buxhet është elektorale dhe një pjesë e madhe e fjalimeve ishin elektorale, mirëpo e vërteta është që ne si qeverisje e LVV-së e kemi këtë numër të anëtarëve të Kuvendit që e kemi, e në këtë kontekst edhe pse ju kemi ftuar të gjitha subjektet politike qysh para se të fillojmë përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore dokument ky nga i cili edhe përgatitet buxheti dhe përveç një subjekti politik që ka marrë pjesë dhe ka qenë shumë i kënaqur, tjerët nuk kanë marrë pjesë. Është jashtëzakonisht mirë që po prioritizohet arsimit, shumë mirë që po prioritizohet kultura, pastaj shumë mirë për ekonominë, mandej për herë të parë kemi ndarë 100,000.00€ subvencione për mbështetje të bizneseve prodhuese përkatësisht norma të interesit për kredit prodhuese të cilat do t'i marrin ato, do të ketë investime në zonën ekonomike por jo ashtu siç ka qenë kod buxhetor që e ka mbajtur LDK për 20 vite (nganjëherë analizë fizibiliteti e nganjëherë zonë ekonomike, vetëm ua ndërronte emërtimet), e që tani ka filluar shpronësimi dhe procedurat tjera, pastaj fatmirësisht kemi një Qeveri serioze, jo qeveri koti, kështu që dhe është duke e kryer punën edhe investimet buxhetore janë të parapara e që do të bëhet një zonë ekonomike prej 37 hektar, madje është duke u bërë edhe projekti dhe shpejt mund ta shihni si projekt arkitektonik dhe vizual i cili është duke u bërë për zonën ekonomike.

Çështja e kulturës, u tha këtu janë 100,000.00€ dhe për herë të parë kultura ka këtë buxhet kaq të theksuar ku janë paraparë 100,000.00€ për shtëpi të kulturës dhe dikush mund të thotë me të drejt si mund të ndërtohet shtëpia e kulturës me këtë shumë të mjeteve, mirëpo e vërteta është se pjesa dërmuese rreth 90% apo më shumë do të jetë investim qeveritar por neve na është nevojitur vetëm ta fusim si kod buxhetor në mënyrë që të ndërtohet shtëpia e kulturës, pastaj kemi planifikuar investimet për herë të parë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore e që dihet si ka mbetur trashëgimia kulturore, jo që nuk është mbrojtur por asnjëherë nuk i ka shkuar ndokujt mendja për të investuar në trashëgimin kulturore, përkundrazi keni rrënuar objekte të trashëgimisë kulturore siç ishte shkolla “Naim Frashëri” si shkollë e parë e qytetit ku mësuam shqip në këtë vend por ju (ish qeverisja) keni shkuar dhe e keni rrënuar, ky është krim dhe për këtë nuk e keni pasur as vetëdijen se çka është një trashëgimi kulturore dhe çfarë do të thotë trashëgimi kulturore në këtë qytet dhe në këtë vend, prandaj e them arsyeja e mos votimit të këtij projektbuxheti është elektorale dhe kjo është shumë e qartë dhe besoj se edhe ju jeni në dijeni shumë mirë, por sa po e shoh unë nuk do të kaloj, mirëpo pas 3 javëve (me kismet) do të kaloj sepse do të jetë kjo sallë goxha e kuqe sikurse ngjyrat e vetë kësaj salle.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të faleminderit drejtori i DBF-së, por këta këshilltarë të Kuvendit këtu në këtë sall janë këshilltarë të zgjedhur të qytetarëve të Komunës së Podujevës, janë legjitim deri në përbërjen e Kuvendit tjetër dhe besoj që qytetarët do të reflektojnë qysh është më së miri dhe ardhshin ata të cilët vërtetë e meritojnë t’i përfaqësojnë qytetarët.

z.Mehmet Gashi, theksoi, nuk desha të marrë fjalën për replikë, por meqë mu përmend emri, dëshiroj të jem korrekt e që besoj se të gjithë e dini se unë nuk merrem me shpifje apo me keqpërdorime. Ato që i ceka më herët, ju kam referuar buxhetit 2001 që është miratuar me 15 shtator 2001 për vitin 2021 dhe prioritetet për vitet 2022/2023, dhe të gjitha ato të dhëna që i ceka as edhe për një cent nuk do të ndryshojnë por janë të sakta, madje edhe buxheti figuron këtu, shembull, ta marrim buxhetin e miratuar për vitin 2021 për të cilin drejtori parafolës e tha se 23,853,654.00€ është shuma e gjithëmbarshme, buxhet i cili është e nënshkruar nga ish Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari dhe mund ta shihni këtë, tani shuma për këtë vit është 23,449,521.00€ dhe është saktë ajo që e ceka më herët, pra rreth 404,000.00€ është më e vogël, kurse përse kanë hyrë ato investime unë nuk e di, por është miratim i buxhetit nga ky Kuvend.

Çështja tjetër që më shtyri që më shumë më shtyri të marrë fjalën ishte debati i Kryetarit në TV kur thotë 5 herë e kam rritur buxhetin në arsim, 5 herë në shëndetësi, 10 herë më shumë i kam rritur të ardhurat dhe të hyrat vetanake të Komunës por nëse thotë 10, i bie rreth 10 milion euro që i paska të hyrat vetanake. Më pëlqej diskutimi i z.Haki Rudarit edhe pse shpesh nuk jam pajtuar me të fare, mirëpo kësaj radhe e ka dhënë një vërejtje me vend sepse vërtetë është dashur që buxheti të sillet në Kuvend në fillim të muajit e që pastaj do të kishte mundësi të korrigjohet dhe të plotësohet, mirëpo nëse mendoni se është mirë që të mbeten ashtu projektet si të përgjithësuara nëpër fshatra, madje edhe nga fundi jugut e deri tek fillimi i veriut të Komunës tonë ku përfshihen 5-6 fshatra në një projekt, dhe pastaj t’ju thoni në debat të gjithëve që po e kam miratuar buxhetin dhe kam për ta realizuar, por ta dini një se nuk ka rrugë në territorin e Komunës së Podujevës deri në 50 metër që nuk është e emërtuar. Pastaj janë rreth 3 mua që prej është sjellë KAB dhe ka pasë 100 herë mundësi të korrigjohet, madje edhe projekteve më të gjata t’jua vendosni rrugën, sa metër gjatësi dhe gjerësi në mënyrë që afërisht ta dini edhe buxhetin, mirëpo na është sjellë një buxhet për dikë 30,000.00€, për dikë tjetër 40,000.00€ siç është rasti për një grumbull fshatrash, e që kjo mënyrë për mua është e pa pranueshme si me përvojë që jam sepse të paktën 10 herë nga paslufta kam arsyetuar buxhetet e Komunës dhe nuk ka ndodhur kurrë të mos miratohen, prandaj atë që e them jam i saktë kur jap të dhëna e të cilat mund t’i verifikoni sepse janë edhe incizimet.

Prandaj rritjet e proklamuar të buxhetit, edhe nëse qëndrojnë, le ta miraton Kryetari i Komunës këtë buxhet, mirëpo siç dihet i vetmi organ dhe autoritet që e miraton buxhetin është Kuvendi i Komunës dhe është çështje që nuk mund t'ia delegoj askujt tjetër, mirëpo nuk është sjell në fillim të muajit siç e tha edhe z.Haki Rudari e që besoj se do kishim gjetur rrugë, mirëpo tani nuk e di sakt proceduar, por nëse keni mundësi që brenda 3-4 ditësh ta ri sjellëni sërish me një mbledhje të Kuvendit ngase deri sa të inaugurohet Kuvendi i ri i Komunës ne e kemi legjitimitetin, prandaj kemi edhe mundësi tjera për mbledhje të Kuvendit, por vetëm urdhëroni bëni përmirësimet e buxhetit dhe unë besoj që jem të gatshtëm t'i marrim parasysht.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, së pari më vije shumë mirë që është ngritur standardi i diskutimit për buxhet, gjegjësisht për specifikimin e buxhetit gjë që edhe unë jam që të bëhet specifikim për secilin investim që bëhet dhe për këtë më duket ka ndikuar LVV që ky standard të rritet për shkak se ju në të kaluarën keni miratuar buxhetin pa e ditur fare se ku kanë për të shkuar investimet, madje e keni miratuar edhe buxhetin e vitit të kaluar ku në vitin 2022 tek Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është një pozicion që shkruan ngritja e infrastrukturës që nuk dihet se për ka bëhet fjalë. Sa i përket shkollës së fshatit Llugë që u përmend disa herë se është paraparë ndërtimi në vitin 2022 dhe duke e arsyetuar këtë me prejardhjen e Kryetarit, drejtori i DKA-së e sqaroi shumë mirë, por duhet ta keni parasysht edhe faktin që shkolla në fshatin Llugë e cila është djegur dhe siç e dini të gjithë edhe gjendjen nuk e ka të mirë, ndërsa shkollat tjera që ju përmendët janë shkolla të cilat janë zhvendosur në prioritetet e vitit 2023.

U tha që nuk është mirë të punohet për vendet nga vijnë, u përmend fshati Llug prej nga vije Kryetari i Komunës se po punohet dhe është në fokus, u përmend edhe fshati Gllamnik prej nga vije unë por që u tha se nuk po punohet, tani është mirë ta dimë se a më mirë t'i fuqizojmë ato vende prej nga vijnë apo të bëhen ankesa.

Adresimi që po e bëjë tani po e bëjë në mënyrën më të mirë të mundshme, po ju drejtohem dhe po ju kërkoj që para se të votoni pro ose kundër, kryesisht ju që mendoni të votoni kundër këtij projektbuxheti të mendoni edhe njëherë dhe ta mendoni që në kuadër të këtij buxheti janë të parapara shujtat e nxënësve, janë të parapara kabinetet shkollore dhe përmirësimi i infrastrukturës së shkollave, është paraparë rinovimi i qendrave shëndetësore, për herë të parë financimi i interesit të ndërmarrjeve prodhuese me financimi i kredive, është e paraparë edhe zona industriale, janë të parapara investimet për kulturë, artistë si dhe shumë investime në infrastrukturë. E di që shumë prej diskutimeve që ju i bëtë ishin për shkak të fushatës zgjedhore, mirëpo edhe mos votimi i këtij projektbuxheti ju ndikon në fushatën e juaj zgjedhore për shkak se ju kur shkoni ta kërkonit votën tek qytetarët ata kanë për të thënë “ti je ai që nuk e votove buxhetin”, kështu që në mënyrën më të sinqertë të mundshme po ju kërkoj të reflektoni dhe mos t'i lëni keq qytetarët e Komunës së Podujevës.

z.Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit për këtë mesazh e nderuar Nënkryetare e Komunës, konsideroj që mjaft gjerë u debatua për këtë pikë të rendit të ditës, andaj nëse nuk ta interesuar tjerë për të marrë fjalën, unë e vë në votim këtë propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe prioritetet për vitet 2023-2024.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 12 vota janë PËR, 19 vota KUNDËR dhe 1 VOTË e përmbajtur, nuk miratohet propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024

Me propozim të një numri të këshilltarëve të Kuvendit për pauzë, Kryesuesi i Kuvendit kërkoj të deklarohen për këtë. Meqë shumica e këshilltarëve ishin që të shkohet në pauzë për një orë, Kryesuesi i Kuvendit i njoftoj se mbledhje vazhdon në ora 13:30
Pauzë 12:30

Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 13:50.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, konstatoi kuorumin ku prezent për momentin ishin 25 (por në vazhdim të mbledhjes prezent ishin 31 këshilltarë të Kuvendit), shtoi, pra kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës aty kemi mbetur.

3. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, dihet se tatimi në pronë përcaktohet me Ligjin për tatimin në pronën i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, njëkohësisht vlerësimi i pronave dhe i zonave të tëri kryhet nga Ministria e Financave dhe ajo që mbetet në kompetencë të Komunës është vetëm caktimi i normave tatimore për të gjitha njësitë e pronave. Vlen të ceket se pa marrë parasysh që ky propozim vendim përmban norma tatimore për njësitë bujqësore, ende nuk aplikohet kjo normë tatimore e që nuk e besoj se do të aplikohet as në vitin 2022, mirëpo Ministria e Financave na ka obliguar që të përcaktohen normat tatimore sepse ende definitivisht nuk është marrë vendim nga Ministria e Financave që të filloj aplikimi i kësaj norme tatimore. Përndryshe për njësitë tjera të pronave, norma tatimore aplikohet e që janë caktuar në minimum sa e parasheh Ligji përkatës, përndryshe janë të njëjtat norma tatimore të cilat janë aplikuar edhe në vitin aktual dhe kemi të njëjtin propozim vendim edhe për vitin 2022.

z.Qëndrim Softolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022, bëhet sipas Ligjit përkatës dhe kjo është në nivel të vendit/shtetit, prandaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim si të tillë.

znj.Doruntina Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, edhe ne e mbështesim propozim vendimin për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2022. Normat tatimore janë të përcaktuara në minimumin sa e parasheh Ligji përkatës, kështu që ne i mbështesim caktimin e këtyre normave tatimore.

z.Bashkim Sylaj, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, edhe ne e përkrahim miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 26 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, miratohet propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2022.

4. Propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera, theksoi, kemi të bëjmë me obligime që kanë rrjedhë nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste e cila ka qenë e rregulluar me Rregullore dhe janë aplikuar që nga janari i vitit 2002. E vërteta rreth kësaj takse është se kjo problematikë nuk i takon vetëm Komunës së Podujevës, por pothuajse gjitha Komunitetet janë përball me këtë problematikë, taksë e cila pothuajse ka qenë kryesisht fiktive ku bizneset nuk e kanë paguar fare këtë taksë dhe rrjedhimisht është grumbulluar një borxh në shumë 3,856,046.00€. Pra është taksë dhe borxh fiktiv e cila Komunës së Podujevës është duke i shkaktuar probleme në raportin e performancës, edhe në raportin e pasqyrave financiare si dhe vërejtje të vazhdueshme nga ana e Auditorit të Përgjithshëm, në njërin anë ekziston si borxh fiktiv, në anën tjetër figuron si llogari e arkëtueshme e cila nuk mund të mbledhet rrjedhimisht. Një numër i madh i këtyre bizneseve që figurojnë në listën e borxheve që e kam këtu para vetës janë biznese të cilat nuk ekzistojnë më, janë regjistruar biznese të reja dhe kjo rrjedhimisht është një borxh i pa mbledhshëm kur dihet se edhe me Ligjin përkatës i cili rregullon parashkrimin, si të kalon mbi tri vite rrjedhimisht borxhi parashkruhet.

Në vitin 2020 kjo taksë nuk është aplikuar sepse është miratuar në Kuvend të Komunës vendimi sipas të cilit janë liruar nga kjo taksë për shkak të Pandemisë, pastaj në vitin 2021 kjo taksë është larguar tërësisht me Rregullore e cila është miratuar para disa muajve dhe më nuk figuron si taksë komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste, kështu që e kemi propozuar dhe e kërkojmë si shumë të dobishme largimin nga lista të borxhlinjve të këtyre bizneseve për arsye se sërish po e them se është një borxh i keq i cili figuron në listat e Komunës së Podujevës dhe në anën tjetër po shkakton disa probleme bizneseve të Podujevës sepse ta zëmë, një biznes i cili aplikon për ndonjë kredi, projekt ose ndonjë tender në ndonjë institucion tjetër jashtë Komunës së Podujevës, banka ia kërkon një vërtetim prej Komunës së Podujevës që ai biznes nuk është borxhli në Komunën e Podujevës, ndërkohë që ne pastaj ndodhemi para një situatë që as nuk mund të lëshojmë atë vërtetim të tillë sepse në fakt formalisht është borxhli, mirëpo de-facto ai është borxh i cili nuk mund të mbledhet. Me një fjalë është borxh i cili vetëm është duke shkaktuar probleme dhe as nuk sjellë dobi për buxhetin e Komunës së Podujevës sepse s'janë borxhe që mund të mbledhen, por vetëm po shkakton probleme për bizneset e Komunës së Podujevës.

z.Qëndrim Softolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, në seancën e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 29 prill 2021, Ekzekutivi i Komunës na e sjelli rregulloren për ndryshim plotësimin e taksave, tarifave dhe gjobave. Vlen të theksohet se brenda kësaj nuk kishte lehtësim apo falje, por vetëm ngritje të tarifave, taksave dhe borxheve për biznese të cilat ushtrojnë veprimtari biznesore në Komunën tonë, kurse ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e kundërshtuam dhe nuk lejuam që rregullorja e tillë të kalojë, ndërsa tani në kohë fushatë të zgjedhjeve vie ky propozim për falje të atyre borxheve.

Sa i përket faljes së borxheve të krijuara nga taksa për ushtrimin veprimtarisë afariste, ne normal e përkrahim sepse qysh herët e kemi ngritur këtë shqetësim, konkretisht ka qenë propozim i imi dhe i kolegut z.Mehmet Gashi që të falen këto borxhe, pasi që kemi të bëjmë me një borxh vështirë të inkasueshëm dhe vetëm shkakton probleme, prandaj në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së ne e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Bahri Blakqori, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, duke pasë parasysh vendimin e Kryetarit të komunës për faljen e këtyre obligimeve apo borxheve për periudhën 2002 deri në vitin 2021 që jemi, ne si Grup i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim si të tillë këtë propozim vendim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për faljen e borxheve ne jemi deklaruar edhe në mbledhjen e KPF-së që jemi për t'i falë ato borxhe, por jo në këtë formë dhe në këtë moment.

Sa i përket deklarimit të drejtorit të DBF se shumica prej këtyre kompanive apo subjekteve afariste janë fiktive dhe nuk funksionojnë, është dashtë të na sjellë materialin/listacionin përkatës të atyre kompanive/bizneseve. Këshilltari kolegu parafolës e tha që është disponimi apo vendimi i Kryetarit të Komunës, por unë i them se Kryetari i Komunës nuk mund t'i falë borxhet hiq sepse nuk ka kompetencë për një gjë të tillë ngase borxhet i falim ne si Kuvend i Komunës, pra nëse Kryetari mund ta bëjë një gjë të tillë nuk do ta sillte propozim vendimin fare në Kuvend.

I nderuar drejto i DBF-së, për ta marrë një vendim të mirë dhe në interes të përgjithshëm, ne të presim këtu për 20 minuta, është mirë të shkosh në zyrë dhe ta sjellësh dokumentacionin/listacionin e kompanive/bizneseve, ndaj ato që janë fiktive dhe nuk funksionojnë, ne po jua falim borxhet, pastaj arsyetoje faljen për këto që janë duke funksionuar përse nuk i shlyejnë këto obligime si dhe na jep një arsyetim për ata që janë duke i paguar këto obligime, dhe ne pastaj e votojmë. Pra kjo është qëndrim i Grupit të këshilltarëve të PDK-së dhe i imi konkret, kështu që në rast se nuk e bënë këtë që e kërkoja atëherë ne nuk mund të bëjmë diferencime sikurse në tentimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale ku shembull, drejtori përkatës potencojke se ky apo ai biznes duhet të gjobitet prej 500 € deri në 1000 €, pastaj njëri duhet të punoj kurse tjetri jo, prandaj e them se vendimi duhet të jetë në interes të qytetarëve dhe të bizneseve, por jo në interes të “kapadaive” të askujt.

Pra ndaje listën e bizneseve që janë fiktive dhe i falim sepse nuk merremi me at që nuk funksionojnë dhe fundja nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Për ato biznese që janë duke funksionuar mund ta shohim se a ka ndonjë që është duke marrë punë në Komunën e Podujevës, a janë duke kryer punë dhe a janë duke krijuar të hyra për Komunën, madje është sistemi ku ne edhe nga këtu mund të shikojmë se a kanë marrë punë në ndonjë Komunë tjetër, dhe nëse gjejmë fakte ai biznes nuk është për t'ia falë borxhet, por është për t'ia inkasuar strikt tatimin sepse është kompani e fortë dhe funksionale. Pastaj çfarë do t'iu thoni atyre që kanë paguar borxhet e tilla. Pra e them se ka kompani e cila është duke funksionuar dhe ju po ju falni borxhin në fjalë, prandaj po e kërkoj që ti drejtor t'i sjellësh dokumentacionet se kujt po dëshironi t'i falni borxhet, ne i analizojmë këtu, ose merrni përgjegjësinë ju të thoni se këto apo ato firma nuk funksionojnë dhe do ta mbështesim, pra e përsërisë që ky është qëndrim i joni si Grup, përndryshe nuk votojmë për, për shkak të arsyeve që i cekëm, mirëpo sërish kërkoj që të shkoni dhe t'i sjellëni dokumentacionet përkatëse për 20 minuta, ne i shqyrtojmë dhe në fund i votojmë për faljen e borxheve, gjë të cilën mund ta bënë drejtori i DBF-së por vetëm varet nga vullneti i tij, nëse nuk dëshironi, ne nuk po dëshirojmë që ata që kanë paguar t'i shtim sërish të paguajnë, këta që e kanë një arsye qoftë politike qoftë “zotnillakut” që mendojnë se vetëm ata ja bëjnë ashtu, ne nuk dëshirojmë t'i lirojmë prej kësaj takse. Pra kjo është çfarë po kërkojmë ne dhe këtë keni mund ta bëni shumë lehtë sepse unë e kam kërkuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe kam pritë që sot do të sjellën dokumentacionet sepse kam kërkuar t'i nxjerrni dhe t'i ndani kompanitë/bizneset fiktive dhe çështje tjera, pastaj ne do ta marrim qëndrimin në mbledhjen e Kuvendit, kurse ju drejtor nuk keni lëvizë fare por vetëm keni ardhë në këtë seancë, kështu që mbetet që vota të shkoj kundër, sepse kjo ose është njëfarë inati politik që nuk po dëshiron ta bësh ti drejtor i DBF-së, ose është që pastaj ju të dilni nëpër rrugë dhe

të thoni se nuk po votojnë partitë që janë opozitë (PDK, AAK, LDK), por kështu nuk shkon sepse në faqen zyrtare të komunës Kryesuesi i Kuvendit duhet të lëshoj lajmin se NN vendimet u morën në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës, për këtë dhe atë arsye, prandaj e them se kërkesën që e potencova mund ta bësh drejtor, ne këshilltarët besoj se presim për 20-30 minuta, kuorumin ta bëjmë, por vetëm mbetet që të shkoni në zyrë, ta printoni listën dhe t'i ndani kompanitë fiktive, i ndajmë dhe shikojmë se si t'ia bëjmë këtyre tjerave me atë borxh dhe në fund votojmë dhe marrim vendim lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës përfshirë edhe drejtorin e DBF-së për ndonjë sqarim apo përgjigje rreth çështjeve që u ngritën, nëse jo, e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 23 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe 7 vota të PËRMBAJTURA, miratohet propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Informatë Drejtorisë së Arsimit për përgatitjet e vitit të ri shkollor 2021/2022

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj informate, ndër të tjera theksoi, para vetës keni informatën për përgatitjet e vitit të ri shkollor 2021/2022. Drejtoria e Arsimit në funksion të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022 ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte për fillimin me kohë të këtij vitit shkollor, por jeni në dijeni se procesi shkollor është shtyrë në gjithë Republikën e Kosovës. Ne kemi bërë sigurimin e kuadrit shkollor për vitin 2021/2022 duke respektuar konkursin, duke angazhuar edhe disa psikologë që tani veç jeni në dijeni, është bërë regjistrimi i nxënësve prej klasës së I-së deri në klasën e X-të.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës kemi intervenuar në 31 shkolla, jemi në proces të ndërtimit të 3 fushave sportive. Pastaj në kuadër të pajisjeve me kabinete, jeni në dijeni se jemi në fazën e loto-II, përkatësisht pjesës bazike të laboratorëve për të vazhduar edhe me loto-I dhe loto-III ku janë pjesët thelbësore të këtyre laboratorëve dhe përfshirja është bërë në 23 shkolla, kryesisht në ato shkolla të cilat kanë pasë edhe sistemin e sigurisë / kamerave. Gjithashtu edhe pajisja me TV monitor në 24 shkolla, në të njëjtën kohë me projektin e “Caritas” kemi realizuar në parashkollor intervenimin në pesë klasë të shkollave të cilat janë të cekura në informatën përkatëse. Mandej kemi bërë blerjen e disa makinave për pastrimin e dysHEMEVE, makina për kositjen e barit, janë instaluar kamerat e sigurisë në 23 shkolla, pastaj projekte të realizuara me Bankën Botërore që arrijnë vlerën në shumë 31,520.00€.

Gjithashtu gëzohemi që për herë të parë siguri i transportit të nxënësve është bërë në kohë dhe kontratat janë lidhë ashtu që në bazë të Udhëzimit Administrativ që përcakton mbi 4 km do të bëhet bartja e nxënësve. Mandej është bërë siguri i masës drunore dhe peletit nëpër shkolla në bazë të kërkesave dhe nevojave që kanë shkollat, është bërë intervenimi në 20 shkolla sa i përket riparimit dhe rrethojave, është bërë dezinfektimi i shkollave, dhe pa e zgjatur më shumë, i'u dëshirojmë dhe i'u urojmë të gjithë nxënësve dhe punëtorëve të arsimit një vite të mbarë shkollor dhe të suksesshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe në emër të Kuvendit të komunës i'u shprehim suksese dhe shëndete gjithë nxënësve dhe punëtorëve arsimor.

z. Shaban Bajoku, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, të gjithë nxënësve dhe punëtorëve të arsimit i'u urojmë fillimin e mesmit dhe dhashtë Zoti që sa më shpejt të krijohen kushte për një zhvillim normal të mësimi.

Unë kam disa pyetje për Drejtorinë e Arsimit, dhe atë; 1-pagat përcjellëse për punëtorët që dalin në pension i kanë marrë nga data 01 janar 2019 deri më 01 mars 2021, mirëpo nga kjo datë e tutje nuk janë paguar, andaj pyes përse nuk janë paguar.

2-investimet kapitale të planifikuara për vitin 2022, disa nga projektet kapitale kanë qenë të planifikuara, shembull (edhe pse u përmend edhe më herët), ndërtimi i objektit të shkollës në fshatin Obrancë, mandej ndërtimi i shkollës në fshatin Dumosh dhe ndërtimi i objektit të sallës së edukatës fizike në fshatin Gllamnik, ndërsa në projektbuxhetin për vitin 2022 të propozuar nga zotëri Bulliqi që ishte në këtë rend dite, nuk figurojnë fare në listë dhe çka është më e rëndësishmja këto projekte zëvendësohen me ndërtimin e shkollës në fshatin Lluga dhe ndërtimin e sallës së edukatës fizike në shkollën "Enver Maloku", mos të keqkuptohemi sepse ne nuk jemi kundër këtyre investimeve në këto shkolla sepse edhe në fshatin Lluga por edhe në shkollën "Enver Maloku" janë të nevojshme këto investime, por përse ka ndryshuar ky planifikim i projekteve.

z. Ragip Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, fillimisht në emër të Grupit të LVV-së dhe në emër timin personal i'u uroj të gjithë nxënësve dhe mësime dhënëseve një vit të mbarë dhe suksese, atyre parashkollor i'u dëshirojmë shëndet dhe mbarësi në jetë.

Arsimi në Komunën tonë është në një gjendje të tillë siç edhe ne e kemi gjetur, për një periudhë të shkurtër kohore nuk është se kemi mundur të bëjmë, ose më saktësisht Ekzekutivi i Komunës ndryshime rrënjësore në atë proces. Drejtori i DKA-së e ceku dhe e falënderoj njëkohësisht për informatën në fjalë lidhur me procesin, atëherë mund të themi se kemi ndryshime pozitive në nivelin organizativ, infrastrukturë, siguri si dhe në fillimin e procesit të digjitalizimit të shkollave siç janë projektorët dhe monitorët e vendosur.

Ajo që unë do të doja të jap disa sugjerime për këtë dikaster, është; -të ketë mbledhje dhe koordinim më të theksuar të drejtorëve të shkollave, pra drejtorët e shkollave të kenë takime më të shpeshta sepse ta zëmë, përse drejtori i Gjimnazit të mos i di problemet e shkollës së fshatrave Pollatë, Zhiti dhe të tjera në mënyrë që të jap sugjerimet se si t'i zgjidhë ato më lehtë, apo drejtori i shkollës së fshatit në Metehi përse të mos i di problemet e shkollës "Shaban Shala" apo "Naim Frashëri" në Podujevë. Pastaj -trajnimi i mësime dhënëseve nga komunitetet jo shumicë, së fundmi është një iniciativë ku një numër i mësime dhënëseve nga komunitetet RAE janë inkuadruar në një projekt për mësim plotësues për nxënësit nga komunitetet jo shumicë, megjithatë unë propozoj që për këta mësime dhënëse të filloj së pari një proces i trajnimit para se të fillojnë punën e tyre për shkak të specifikave e që natyrisht komuniteti RAE edhe i ka. Mandej -angazhimi më i theksuar i psikologëve nëpër shkolla gjatë këtij procesi duke e ditur situatën jo të mirë që ne e kemi, në veçanti problemet psikologjike që i shkakton situata pandemike covid-19, dhe së fundmi -sugjeroj që kjo Drejtori në vitin e ardhshëm shkollor të punoj më tepër në dhënien informatave senzibilizuese dhe informuese në përgjithësi për bullizmin dhe dhunën nëpër shkolla edhe pse kjo Drejtori ka filluar një proces të instalimit të kamerave nëpër shkolla e që ka të bëjë me sigurinë nëpër shkolla.

z. Pajtim Hodolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, fillimisht dua t'ju falënderoj gjithsecilin prej këshilltarëve të Kuvendit për këtë kohë sa kemi rrugëtuar bashkërisht si anëtarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës pasi që sot sipas të gjitha gjasave është seanca e fundit për këtë legjislaturë, dhe njëkohësisht të gjithë atyre që janë në garë për mandat të ri i'u

dëshiroj suksese. Po ashtu pasi që sot ka filluar mësimi në gjithë Republikën e Kosovës, edhe pse me vështirësitë e veta për shkak të pandemisë covid-19, i'u uroj gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve suksese në këtë vite të ri shkollor me shpresën që të jetë një vite i mbarë.

Dua ta pyes drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, si ka filluar procesi mësimor sot, a ka filluar në të gjitha shkollat apo ka ndonjë shkollë që ka vështirësi ose që nuk ka mund të filloj mësimi i rregullt. Po ashtu më intereson të di nëse keni shifra për numrin e nxënësve që kanë filluar klasën e parë në këtë vit dhe a ka ndonjë nxënës i cili e ka përfunduar shkollimin e mesëm të ulët apo klasën e IX-të por që ka mbetur pa u regjistruar në shkollë të mesme. Gjithashtu më intereson të di se a ka shpërngulje të nxënësve prej Komunës tonë në Komunitet tjerë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, në këtë informatë e cila është përgatitur nga Drejtoria e Arsimit ajo që është në interesin tim ta di ka të bëjë me sigurimin e kuadrit mësimorë për vitin shkollor 2021-2022, a është e vërtetë se keni pranuar staf pa konkurs publik, rast konkret kemi në fshatin Sfeçël ku keni sjellë staf dhe po ashtu edhe në disa shkolla tjerë.

Pyetja tjetër për ju drejtor i DKA-së është lidhur me konkursin për drejtor të shkollave, me njoftimin e datës 19 gusht 2021 keni paraqitur listën tabelare dhe çfarë coincidence është se në shkollën “Isa Boletini” në Podujevë, sipas juve drejtori/kandidati nuk i ka plotësuar kushtet, andaj duam të njoftohemi për arsyet e kësaj, a është arsyeja politike, e them këtë ngase jeni thirr në depolitizim sa keni qenë opozitë, mirëpo politizim e keni në fshatin Sfeçël sepse e keni bërë drejtor një mik të Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi, një gjeograf madje e keni pritur deri sa ai person e ka kryer trajnimin përkatës, andaj mendoj se është kontradiktore t'i thuash drejtorit të shkollës “Isa Boletini” nuk i keni plotësuar kushtet, përderisa sipas atyre kushteve sipas Udhëzimit Administrativ përkatës ju e keni thirr në intervistë. E njëjta situatë ndodh edhe në shkollat e fshatrave Dumosh dhe Pollatë, kështu që kur ta shikosh edhe listën e këtyre drejtorëve të shkollave që janë zgjedhur del qartë dhe drejtë se janë njerëz të afërt me LVV-në, në këtë rast me Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi. Pra jo vetëm në shkollën e fshatit Sfeçël, por në shumë shkolla keni drejtor të cilët asnjë ditë përvojë menaxheriale nuk e kanë, dhe në qoftë se nuk kanë atëherë cili ka qenë kriteri i atij komisioni i cili është ngritur dhe votuar nga ky Kuvend.

E kam thënë dhe po e përsërisë, nëse ka qenë keq në kohën e LDK-së, ky subjekt “e ka paguar faturën”, mirëpo nuk mund të nxjerrni konstatime që sot është mirë.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa i përket pagave përcjellëse për punëtorët e arsimit të cilët dalin në pension që e ngriti këshilltari z.Shaban Bajoku, besojmë shumë se në këtë muaj do të dalin, dhe arsyet pse nuk kanë dalë deri më tani unë e kam potencuar edhe në një seancë të mëparshme që niveli qendrorë ka pasë probleme me buxhetin për shkak të “avullimit” të atyre 2 milion euro, dhe normal që krijon pengesa të kësaj natyre. Për fat të mirë Komuna e Podujevës i ka pasë të planifikuara mjetet për këtë çështje dhe deri në muajin shkurt janë paguar, por nga muaji mars janë ndal në gjithë Kosovën, jo vetëm tek ne. Janë kërkuar edhe disa dokumente shtesë të cilat ne si DKA jua kemi përcjellë, dhe ka zotim se do të kompensohen.

Sa i përket investimeve kapital, kjo çështje besoj se veç u konsumua në debatin për propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2022, tani mund të themi çfarë të doni mirëpo përgjigja përfundimtare është se Ekzekutivi i Komunës e ka parë më të arsyeshme të investoj aty ku edhe është planifikuar, kështu që nuk janë përjashtuar as shkolla “Ali Hadri” e as shkolla e fshatit Dumosh, por janë bartë për një vite ashtu siç e ka bartë ish qeverisja projektet e mëhershme, pra kemi konsideruar se shkolla në fshatin Lluga ka qenë e nevojshme, jo pse Kryetari i Komunës vie nga ai fshat, por është më e nevojshme.

Sa i përket çështjes së mbledhjeve/takimeve të drejtorëve të shkollave, çështje të cilën me të drejtë e potencoj edhe këshilltari z.Ragip Fetahu, kemi bërë mbledhje/takime nëpër grupe me drejtorë të

shkollave të qytetit por edhe të shkollave të fshatrave, mirëpo për shkaqe të kushteve pandemike nuk kemi mbajtur mbledhje/takime me të gjithë përnjëherë, prandaj e vlerësoj se është e nevojshme dhe ide me vend që të paktën njëherë në muaj të ketë takim të drejtorëve të shkollave me qëllim që t'i ndajnë idetë e tyre.

Sa i përket mësimi shtesë për komunitetet jo shumicë, ne pra vetëm po fillojmë nga ky muaj dhe pajtohemi se kanë nevojë për trajnime e që do ta angazhojmë stafin përcjellës për trajnime të tilla.

Këshilltari z.Pajtim Hodolli parashtroi pyetje se si ka filluar procesi mësimor, për fat të mirë konsiderojmë se në bazë të informatave të para që kemi marrë, procesi mësimorë ka filluar mirë, ka filluar me skenarin A, që është me prezencë në shkollë dhe ky është një lajmë i mirë.

Në klasën e I-rë janë regjistruar 1258 nxënës, ndërsa rreth asaj që u tha se sa nxënës janë që kanë kryer shkollimin fillor dhe që kanë mbetur pa u regjistruar, aktualisht e kemi një numër prej 42 personave të cilët po sillen nëpër shkollë, mirëpo janë të vëmendshëm se kriteret janë kritere dhe do të zbatohen deri në fund në mënyrë që aty ku e meritojnë aty edhe do të vendosen andaj për këtë arsye shkollë teknike i ka dyert e hapura për këtë numër të nxënësve, ndërsa sa i përket shpërnguljes së nxënësve, në bazë të statistikave që i kemi vitin e kaluar ka pasë një shpërngulje më të madhe prej 87 nxënësve, kurse këtë vit kemi 67 nxënës të cilët janë shpërngulur në Komunë tjera dhe kryesisht në drejtimet që ne nuk i kemi pasë për arsye se jeni në dijeni se dy paralelet e mjekësisë paksa me vonesë u aprovuan.

Sa i përket pyetjes rreth konkursit për shkollën e fshatit Sfeçël, i nderur z.Hasan Ajeti meqë ju edhe vini prej atij rajoni, kemi një bashkëfshatar tuajin i cili e ka gjendjen e rëndë familjare ku prindi i tij ka shkuar për shërim jashtë vendit, ka kërkuar leje dhe normale që sipas ligjeve në fuqi mund të jepet pushim pa pagësë, dhe nga konkursi që e kemi pasë për punëtorë teknik kemi angazhuar një bashkëvendës tuajin dhe të ish partisë tuaj, kështu që asgjë politike në këtë çështje nuk ka, dhe për këtë jeni në dijeni shumë mirë ju besoj.

Sa i përket konkursit dhe përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave, unë nuk dëshiroj ta politizoj këtë çështje sepse ata persona ne të gjithë i njohim dhe jemi në dijeni se në cilat subjekte politike kanë qenë si dhe a kemi dashtë t'i orientojmë dhe veprojmë politikisht me ata persona, sigurisht se do të ishin të LVV-së, mirëpo po e dimë kush janë ata persona, ju kanë nënshtruar konkursit publik, ka pasë një komision përkatës i cili ka vlerësuar. E vërtetë është se disa prej tyre kanë mbetur vetëm ushtrues detyre, dhe komisioni ka dhënë sqarimin konkret me shkrim arsyen përse nuk janë përzgjedhur.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj informate, nëse jo e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

6. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, besoj që materialin për këtë informatë e keni marrë me kohë të gjithë, andaj jam i hapur për pyetje, sugjerime dhe çfarëdo që e shihni të arsyeshme.

z.Hasan Ajeti, theksoi, tani veç se drejtori i DKA-së z.Avni Fetahu dhe ai i DBPZHR z.Vigan Salihu janë në garë zgjedhore si kandidat për Kuvend të Komunës, kështu që tani nuk po dëshiroj të lëshohem më shumë zotëri Fetahu. Ndërsa drejtori i DBPZHR në këtë informatë e ka bërë një përshkrim të punëve. Sa i përket mbështetjes me mullinj ju kujtoj se ky projekt është i trashëguar dhe i keni ndarë mirë për çka veç ju përgëzoj, për projektin e mëshqerrave e di se keni pasë telashe

temë e cila pothuajse është konsumuar sepse drejtori e din mirë se ku ka pasë telashe, në cilat fshatra dhe në cilin komunitet e që mendoj se do të përsëriten edhe në të ardhmen telashe të tilla.

Pastaj për realizimet e projekteve, me theks serat në sipërfaqe 50m², mendoj se ju kanë dështuar drejtor sepse nuk do të duhej t'i vënit fare 50 m² sepse ne i shpërndanim nga 1 ari dhe në fund dështonim, kurse ju vepruat me gjysmë ari për t'i rritur atë “kubikazhën” e votave por konsideroj se do ta keni më telashe sepse do të keni konkurrencën brenda grupit gjë të cilën e dinë disa më mirë këtë far formati se si shkon kjo çështje.

Pastaj tek sektori i Pylltarisë, në këtë informatë për një pjesë të madhe vetëm keni përshkruar detyrat e punës, kështu që kjo është vetëm finesë teknike. Ajo që konsideroj se është në interes të të gjithëve e në veçanti të fermerëve janë dëmet e shkaktuara për çka keni specifikuar vlerën 400,000.00€, andaj pyes deri ku ka shkuar ky proces, cila është përgjigja dhe cilat janë kapacitetet buxhetore që ju t'i ndihmoni fermerët e dëmtuar dhe në cilat lokalitete.

znj. Adelinë Stublla, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, gjatë këtyre 9 muajve qeverisje edhe DBPZHR ka punuar me intensitet të lartë për t'i realizuar projektet dhe për t'i mbështetur projektet për qytetarët të cilët merren me bujqësi.

Projektet e realizuara janë; mbështetja me mullinj për 50 fermer, mbështetja me mëshqerra për 46 fermer, mbështetja e farë misri dhe projekte të tjera të cilat janë realizuar, siç janë projektet për pemëtari dhe pemëtari, dhe në vazhdim do të vazhdohet edhe projekte të tjera për t'i realizuar për të mirën e qytetarëve.

z. Kasib Bashota, theksoi, fillimisht ju falënderoj të gjithëve për këtë 9 muaj bashkëpunimi si Kuvend dhe Ekzekutiv ku shumica prej këtyre kemi qenë të mirë dhe kemi vepruar në të mirë të qytetarëve. Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sa e kam vërejtur dhe sa e kam parë, e përgëzoj për punën, ka krijuar komisionet të cilat i ka dërguar në teren si dhe prej asaj si dhe siç e kemi vërejtur dhe parë ndarja e subvencioneve ka qenë e drejtë dhe kanë përfituar vërtetë ata që e meritojnë. Nga këtu shprehi rastin t'i falënderoj të gjithëve e në veçanti gjithë qytetarët e Llapit, suksese për të gjithë, shëndet dhe shkoftë puna mbarë për të gjithë.

z. Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR, theksoi, pati tri çështje që u ngritën, serat, mëshqerrat dhe dëmet e vlerësuar. Sa i përket projektit për sera besoj se kjo çështje është e kurtë edhe në informatën e paraqitur, lidhur me atë se çfarë ka ndodhur e që ne nuk kemi heshtë por kemi ndërmarrë masa konform Ligjit për prokurimin publik, për operatorin i cili na kë vënë në lajthitje lidhur me realizmin e projektit të cekur sepse i njëjti është tërheqë.

Po ashtu sa i përket projektit për mëshqerra, unë mendoj dhe ndihem krenar që është realizuar një projekt shumë i mirë ku për punët e mira që i ka bërë komisioni bashkërisht me mua si drejtor i DBPZHR ne i kemi kthyer 28 krerë të lopëve prapa operatorit përkatës ekonomik që nuk i kanë plotësuar kushtet e që pastaj ato janë zëvendësuar. Ndërsa sa i përket dëmeve të vlerësuar, ne që nga 01 janari 2021 kemi filluar me vlerësimin e dëmeve kudo që kanë ndodhur dhe kemi dalë në vizita në terren si Komision përkatës ku vlera e dëmeve të vlera e dëmeve të vlerësuar ka arrit rreth 400,000.00€, raportet përkatëse janë përcjellë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural dhe kompensimi do të bëhet në fund të vitit, mirëpo ne e kemi edhe një pjesë të buxhetit që do t'i kompensojmë. Pra kjo ishte sa për sqarimet dhe përgjigjet e parashtruara, nëse keni edhe diçka tjetër urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e konsideroj të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

7. Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, pas refuzimit të ministrisë përkatëse që të jap pëlqim për vendimin e kaluar lidhur për vendosje në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale, ne jemi detyruar që sërish të sjellim për miratim në Kuvendin e Komunës një vendim për vendosje në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale, gjithmonë në koordinim me Ministrinë përkatëse, andaj luteni që ashtu si herën e kaluar edhe tani ta miratoni këtë dokument tepër të rëndësishëm për Komunën e Podujevës.

z.Hasan Ajeti, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, pa dyshim se Harta Zonale është dokumenti më i rëndësishëm strategjik i Komunës i cili sigurisht se do të miratohet nga Kuvendi i ardhshëm i Komunës, por ajo që është e rëndësishme sot i nderuar drejtor i DPUMM është se a janë të gatshme dhe të miratuara këto dokumentacionet nga Ministria përkatëse, pyetje kjo e cila është legjitime dhe lidhet direkt me vlefshmërinë e aktit në të ardhmen. Ne të gjithë jemi në dijeni se këto telashe e ka përcjellë në këto dy muajt e fundit Ekzekutivin e Komunës të udhëhequr nga z.Shpejtim Bulliqi i cili në takimin me shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit ishte shumë konfuzë por sigurisht se nuk e njeh materien ai sepse është i fushës së Gjeografisë dhe ka pasë telashe, mirëpo është përgjegjësi e këtij Ekzekutivi që ky propozim vendim të përgatitet në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe që nesër pa dyshim të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e kemi mbështetë çdo herë dhe e mbështesim edhe sot vënien në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale, por duhet ta kuptoni një gjë se duhet ta konsultoni bazën ligjore, nëse nuk është mirë atëherë përgjegjësinë e merr zotëri Bulliqi sikurse që sot po ai po pretendon se ai është i cili po vë në diskutim publik këtë dokument të Hartës Zonale, pra edhe njëherë po e them se është interes i të gjithëve pa dallime dhe në këtë pikë mendoj se duhet të tejkalohen bindjet dhe qëllimet politike sepse kemi të bëjmë me interes të përgjithshëm. Pra edhe njëherë po e përsërisë se ne do e mbështesim në parim, por të kihet kujdes në dokumentacionin e Ministrisë së linjës.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështetë propozim vendimin për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale të Komunës në afatet e parapara me Ligji që është për 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe me plotësim ndryshimet hartuara nga DPUMM, dhe kjo gjithëherë konform vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021.

z.Fatmir Rudari, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, duke e parë rëndësinë e Hartës Zonale për Komunën e Podujevës, edhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së do ta mbështesim që kjo të vëhet në shqyrtim publik.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush nga këshilltarët apo nga Ekzekutivi i Komunës dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri nga të pranishmit në sallë, përkatësisht me 27 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, miratohet propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021

8. Të ndryshme

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, para se ta mbylli këtë seancë, ju përshëndes të gjithëve dhe njëkohësisht ju falënderoj për bashkëpunim dhe kontributin e dhënë duke shpresuar t'ia kemi arritur atë për çka na kanë votuar qytetarët për këtë mandat që po e lëm pas, ndërsa të gjithë atyre që janë konditat për Kuvendin e Komunës urojmë të kenë suksese, fat dhe shëndet.

Mbledhja përfundoi në ora 14:40

**Procesverbalin e mbajtën
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0085304/21
Podujevë,
27 shtator 2021**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**